

Israr Ahmad Khan


Autentifikimi i haditheve

Ripërkufizimi i kritereve



AUTENTIFIKIMI I HADITHEVE
RIPËRKUFIZIMI I KRITEREVE

Israr Ahmad Khan



© LOGOS·A
S H K U P
P R I S H T I N Ë
T I R A N Ë
2 0 2 1

BOTON: LOGOS-A
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Sedat Halimi
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Shtypi: Focus Print
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

www.logos-a.com

ISBN 978-9989-58-843-3 Paperback
Copyright©Logos-A, 2021
©Center for Advanced Studies
©The International Institute of Islamic Thought (IIIT)


Tirazhi: 700

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.

Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.



AUTENTIFIKIMI I HADITHEVE

RIPËRKUFIZIMI I KRITEREVE

Israr Ahmad Khan

PËRKTHEU NGA ANGLISHTJA:

Arjol Guni

TITULLI I ORIGINALIT:

Dr. Israr Ahmad Khan

AUTHENTICATION OF HADITH:

Redefining the Criteria

The International Institute of Islamic Thought (IIIT),

London & Washington, 1431 h./2010

ISBN 978-1-56564-448-9 Paperback

ISBN 978-1-56564-449-6 Hardback



LOGOS·A

Ky libër u botua me mbështetje të
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam



PËRMBAJTJA:

Fjale e botuesit.....	9
Mirënjohje	19
Përdorimi i fjalës “traditë” për të treguar hadithin dhe sunetin	21
Hyrje	23
Parathënie	27
KAPITULLI I PARË	43
Trillimi në traditat pejgamberike: Faktorët shkakësorë dhe masat korigjuese	45
Sfondi historik i trillimit të haditheve	46
Shkaqet e trillimit.....	48
Kontributi i dijetarëve muslimanë në identifikimin e traditave të trilluara.....	74
KAPITULLI I DYTË	85
Kontributi i dijetarëve muslimanë në Autentifikimin e hadithit	87
Senedi dhe metni i hadithit	87
Autentifikimi i hadithit: Një sfond i shkurtër historik.....	87
Vlerësimi i zinxhirit dhe i tekstit	91
Roli i Buhariut dhe Muslimit.....	98
Imam Buhariu	99
Imam Muslimi	100
Autentifikimi i hadithit nga një perspektivë tekstuale.....	101
El-Mevdu’at nga Ibn Xhevzi.....	101
El-Menar ‘ul-Munif fi ‘s-Sahih ve ‘d-Da’if nga Ibn Kajimi	102
Makajis Nakd ‘ul-Mutun ‘is-Sunneh nga Damini	103
Kriteret e Shqyrtimit Tekstual të Sunetit nga Sahabët.....	103
Kriteret e shqyrtimit tekstual të sunetit nga dijetarët e hadithit....	105
Kriteret e shqyrtimit tekstual të sunetit nga juristët.....	108

KAPITULLI I TRETË	113
Kur’ani dhe Autentifikimi i hadithit.....	115
Të kuptuarit e pozitës së Kur’anit në raport me hadithin	115
Qasja e Aishes	117
Pozicioni i Omerit	120
Perspektiva e Abdullah ibn Abasit	120
Komenti i Ebu Hanifes	121
Vrojtimi i Shafiut	121
Komenti i Ibn Kajim Xhevziut	122
Shembuj relevantë	122
 KAPITULLI I KATËRT	153
Autentifikimi i hadithit nëpërmjet traditave racionalisht autentike	155
Qasja e Aishes	156
Qëndrimi i Ebu Hurejres.....	161
Shembulli i Hajr Abadit: Një kritikë.....	161
Krahasimi i haditheve: Një detyrë delikate	162
 KAPITULLI I PESTË	173
Autentifikimi i hadithit nëpërmjet arsytimit të shëndoshë.....	175
Përkufizimi i arsytimit të shëndoshë.....	176
Konkluzion	221
 KAPITULLI I GJASHTË	223
Autentifikimi i hadithit nëpërmjet historisë së njohur.....	225
1. E para që vdiq mbas Pejgamberit, Sevdja apo Zejnebja?	226
2. Medina apo Siria si vendi i vdekjes së Ebu Sufjanit.....	227
3. Hubejb ibn Isaf apo Hubejb ibn ‘Adi, një luftëtar në Betejën e Bedrit.....	227
4. Vendbanimi i bijës së Pejgamberit, Fatimesë	228
5. Ndëshkimi për pirjen e alkoolit, tetëdhjetë fshikullima kundrejt dyzet	229

6. Moshë e Pejgamberit, gjashtëdhjetë e tre apo gjashtëdhjetë e pesë	230
7. Kohëzgjatja e periudhave mekase dhe medinase	231
8. Diferenca kohore ndërmjet ndërtimit të Mesxhid 'ul-Haramit dhe Mesxhid 'ul-Aksasë	231
9. Oferta që Ebu Sufjani i bëri Pejgamberit për t'i dhënë dorën e të bijës në martesë	234
10. Martesa e Pejgamberit me Mejmunen	236
KAPITULLI I SHTATË	239
Moderimi në lidhje me Autentifikimin e hadithit	241
Pozita kur'anore mbi moderimin	241
Qasja pejgamberike ndaj moderimit	243
Moderimi: Përkufizimi tij i saktë dhe në lidhje me hadithet përkatëse	245
KAPITULLI I TETË	259
Kapitulli i Buhariut mbi paracaktimin: Një vlerësim dhe një interpretim	261
Qasja e përgjithshme në interpretimin e hadithit	262
Reflektim mbi kuptimin e termit El-Kader	263
Vlerësimi dhe interpretimi i traditave në Kitab 'ul-Kader	267
Bibliografia	335
Indeksi	339

*Kushtuar bashkëshortes sime, Shanaz Begum
Një grua muslimane ideale në jetën time*

Dy fjalë mbi librin

Dr. Israr Ahmed Khan (1932-2010) ishte një teolog, filozof, mjek dhe dijetar i njohur musliman pakistanez, nga nënkontinenti indus. Në kulmin e fuqisë së tij, ai kishte një prani dhe ndikim të fortë në Pakistan, Indi, Lindjen e Mesme dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Israr Ahmed Khan u lind si djali i dytë i familjes në rrethin Hisar, një provincë e Panxhabit Lindor në Perandorinë Induse Britanike, sot në shtetin indian Haryana, më 26 prill 1932. Babai i tij ishte një nëpunës civil në Qeverinë Britanike në Indi.

Israr Ahmedi, pasi mbaroi shkollën fillore dhe një shkollë të mesme lokale, u transferua në qytetin Lahorë, për t'u regjistruar në vitin 1950 në Universitetin e Mjekësisë "King Edward", të cilin e përfundoi në vitin 1954. Pas kësaj kohe filloi të praktikonte profesionin e mjekësisë dhe këtë e bëri deri në vitin 1971. Më pastaj, ai mori edhe gradën master në Studime Islame në Universitetin e Karaçit në vitin 1965.

Aktiviteti qytetar, politik dhe intelektual

Israr Ahmedi punoi për një kohë të shkurtër në *Federatën e Studentëve Muslimanë (Muslim Student's Federation)*, në *Lëvizjen e Pavarësisë (Independence Movement)* dhe pas krijimit të shtetit të Pakistanit në vitin 1947, në *Organizatën Studentore Muslimane (Islami Jami`yat-e-Talaba)*, kurse prej vitit 1950 u bashkua me organizatën *Jamaat-e-Islami*, të udhëhequr nga dijetari me famë Ebu'l-A'la Mevdudi, por u largua nga partia kur kjo e fundit vendosi të merrte pjesë në fushatën elektorale dhe zgjedhjet politike në vitin 1957.

Israr Ahmedi dha dorëheqje nga *Jamaat-e-Islami* në prill të vitit 1957, sepse sistemin partiak kombëtar e konsideronte si të papajtueshëm me politikën e miratuar nga *Jama'ati* në periudhën para vitit 1947. Në vend të këtij sistemi ai ofronte alternativën e halifatit të drejtë.

Për shkak të pakënaqësisë politike dhe rritjes së interesimit të tij për Islamin dhe filozofinë, ai më pas u zhvendos në qytetin Karaçi, Provinca Sindh në vitet 1960, ku u regjistrua në Universitetin e Karaçit. Zhgënjimi politik, realiteti jo i mirë i vendit dhe dallimet ideologjike e transformuan atë. Për këtë arsye, ai u distanca nga organizata e Mevdudit dhe në vitin 1975 themeloi *Organizatën Islamike (Tanzeem-e-Islami)*, në krye të së cilës ishte ai. Në vitin 1981, Israri ishte edhe anëtar i *Maxhlis-e-Shura* gjatë qeverisjes së gjeneralit Ziaul-Hak. Qeveria e Pakistanit për meritat e mëdha për shtetin, i dha Israr Ahmedit mirënjohjen *Sitara-e-Imtiaz*.

Pas largimit nga politika aktive, ai i kushtoi të gjitha energjitë e tij hulumtimit dhe botimit të vlerave të fesë islame. Ai ka shkruar më shumë se 60 vepra, e disa burime thonë më shumë se 100 vepra në gjuhën urdu kushtuar fesë islame dhe temës së Pakistanit, shumë prej të cilëve janë përkthyer në gjuhë të tjera. Ai ishte autor i disa librave gjithëpërfshirëse për shpjegimin e Kur'anit Famëlartë dhe biografinë e Pejgamberit s.a.v.s. Israr Ahmedi fitoi një reputacion të madh në vend dhe rajon si komentues i Kur'anit. Pa ekzagjerim, përveç shumë veprave të shkruara, ai ka qindra leksione audio dhe video që janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Mund të thuhet se ai luajti rolin më të rëndësishëm në ngritjen e identitetit të vërtetë të Islamit, i cili nuk do të harrohet kurrë në histori. Shëndeti i lig e detyroi Israr Ahmedin të heq dorë nga udhëheqja e organizatës *Tanzeem-e-Islami* në tetor të vitit 2002. Ai e emëroi të birin, Hafiz Akif Said si lider të organizatës, të cilën detyrë e kryen nga 2002 në 2020.

Idetë kryesore

Israr Ahmedi qe ndikuar nga disa dijetarë vendorë me famë të kohës, si: Wehiduddin Khan, Naim Siddiki dhe Xhavid Ahmed Gamidi. Po ashtu tek Israri ndikoi Sejjid Ebu'l-A'la Mevdudi (1903–1979), me të cilin për një kohë punoi ngushtë. Israri u ndikua dhe bashkëpunoi edhe me dijetarin Mevlana Hamiduddin Farahun dhe Mevlana Amin Ahsan Islahun.

Sipas kritikëve shkencorë, ai ishte ndikuar “thellë” edhe nga Shah Veliullah Dehlaviu, udhëheqësi musliman indus i shekullit XVIII, aktivist anti-kolonialist, jurist dhe dijetar me përmasa botërore.

“Në kontekstin e shpjegimit dhe kuptimit kur'anor”, Israr Ahmedi ishte një tradicionalist i vendosur i sojit të Mahmud Hasan Deobandit dhe Shabbir Ahmad Osmanit; megjithatë ai paraqiti mësimet kur'anore në një mënyrë shkencore dhe të ndriçuar”, në frymën e profesionit të vet, mjekësisë/shkencave ekzakte dhe mësimëve dinamike revolucionare të Mevlana Azadit dhe Mevlana Mevdudit.

Israr Ahmedi në rrafshin politik besoi në atë që ai e quajti “mendim revolucionar islam” (*Tanzeem-e-Islami*), i cili konsiston në idenë që Islami (mësimet e Kur'anit dhe Sunetit) duhet të zbatohet në sferat shoqërore, kulturore, juridike, politike dhe ekonomike të jetës dhe jo të mbyllet në ri/interpretimin e të kaluarës, duke ia mbyllur dyert ixhtihadit. Bashkë me një grup shokësh, thellë besonte se sistemi i hilafetit është rruga më e mbarë për muslimanët. Në këtë ai thuhet se ka ndjekur Muhammed Rafiuddinin dhe Alame Muhammed Ikbali. Në anën tjetër, ai kishte një marrëdhënie të ngushtë me dijetarin e famshëm musliman indus, Dr. Zakir Naik, dhe në këtë drejtim ai gjithashtu vizitoi Indinë disa herë.

Përpjekja e parë drejt aktualizimit të këtij koncepti u raportua të bëhej nga Ebul-Kelam Azadi, përmes partisë së

tij jetëshkurtër, Hizbullah. Një përpjekje tjetër u bë edhe nga Ebu'l-A'la Mevdudi, përmes partisë së tij *Jamaat-e-Islami*. Megjithëse *Jamaat-e-Islami* ka arritur njëfarë ndikimi, Israr Ahmedi dha dorëheqje nga partia *Jamaat-e-Islami* në 1956. Ligjëratat e tij në televizione disa herë ngritën edhe debate e polemika të rrepta. Në fakt, në vitin 1982 ai sugjeroi që gratë duhet të ndalohen në të gjitha profesionet tjera, përveç mjekësisë dhe mësimdhënies. Po ashtu, në një takim me kryetarin e shtetit Ziaul Hak, Israr Ahmed i kërkoi kryetarit që loja e kriketit të ndalohet për shkak të pasojave dhe ndikimit negativ, gjë që preku shumë dijetarë, politikanë etj.

Rreziku nga fuqitë e huaja

Duke parë zhvillimet rajonale e botërore të viteve 2000 e pas, Israr Ahmed Khan ishte një kritik i fortë i ndërhyrjes ushtarake perëndimore, veçanërisht amerikane në vendet islame. Madje, ai ishte për dorëheqje të kreut të shtetit për shkak të lëshimeve ndaj partnerëve jo të sinqertë perëndimorë dhe shfrytëzimin e vendit të tyre si arenë luftimesh, ndërsa të cilat aktivitete nuk ishin në të mirë të Pakistanit dhe muslimanëve në vend dhe jashtë.

Vdekja dhe trashëgimia

Israr Ahmedi qysh më herët ishte i sëmurë. Ai vdiq nga problemet me zemrën, në shtëpinë e tij në Lahorë, në mëngjesin e 14 prillit 2010, në moshën 78 vjeç.

Pas tij mbetën gruaja, katër djem dhe pesë vajza. Një gazetë e madhe pakistaneze në gjuhën angleze komentoj pas vdekjes së tij: "Themelues i disa organizatave si *Anxhuman-i-Huddamul-Kur'an*, *Tanzeem-i-Islami* dhe *Tehrik-i-Khilafat*. Ai kishte pasues në Pakistan, Indi dhe vendet e Gjirit, veçanërisht në Arabinë Saudite. Ai kaloi gati katër

dekada në përpjekjen për të ringjallur interesin për filozofinë islamike të bazuar në Kur'an."

Si t'i qasemi veprës "Autentifikimi i hadithit"

Në botën e sotme komplekse dhe të paqëndrueshme politikisht, ekonomikisht, kulturalisht, emocionalisht, pasojat e mbështetjes në hadithe mashtruese, të trilluara dhe të falsifikuara, për të legjitimuar sjelljet e skajshme, lëshimin e fetvave politike si pasojë e servilizmit dhe lakmisë pas pasurisë së mbretërve, të natyrës së dhunshme dhe justifikuese të abuzimit eklatant, veçanërisht ndaj grave, por edhe shkollave tjera besimore e juridike, në fakt shumë të rrezikshme, me pasoja të gjata në kohë e hapësirë.

Israr Ahmed Khan kapet pikërisht me këtë temë të ndjeshme, të ri/vërtetimit, ri/verifikimit, autentifikimit të hadithit, duke u përqendruar në kriteret e miratuara nga studiuesit klasikë, të shtrirë jo vetëm në saktësinë e zinxhirit të transmetuesve, por edhe të përmbajtjes tekstuale të hadithit. Kjo pikërisht është tentuar të bëhet për t'i ikur kundërthënieve brenda vetë haditheve dhe haditheve e Kur'anit.

Studimi i dr. Israr Ahmedit ndjek në hollësi zhvillimin historik të traditave gojore dhe të shkruara, si dhe shumë përpjekje të synuara për trillime që ndodhën, duke kritikuar me hollësi metodike disa hadithe të cilat janë pranuar gjerësisht si "autentike", por që në fakt kanë një pikëpyetje të madhe pas vetes.

Koleksionet e shquara që kemi sot, si *Kutub'us-sitteh* e tjera, u bënë të mundshme nga zhvillimi i shkencës së kritikës së hadithit dhe studiuesit muslimanë meritojnë vlerësim të thellë dhe konsideratë për punën e tyre të madhe, si dhe kontributin e tyre të paçmuar drejt ruajtjes së literaturës së hadithit. Theksimi i autorit është se procesi i vërteti-

mit, verifikimit, autentifikimit të hadithit është duke vazhduar dhe politika e dyerve të mbyllura, e cila aktualisht rrethon vërtetimin e hadithit duhet të rishikohet me kujdes, sepse “heqja e ixhtihadit” nuk ka vend në mësimin islam në përgjithësi e në shkencën e hadithit në veçanti.

Sistemi islam i besimit, mendimit, aktiviteteve jetësore, rendit shoqëror, sistemeve ekonomike e politike, limiteve kulturorë, parimeve morale, normave arsimore, kodeve intelektuale dhe ligjeve fetare rregullohen të gjitha nga Kur’ani dhe Hadithi. Kur’ani përfaqëson fjalët e shpallura saktësisht të Allahut xh.sh. dhe Hadithi përbën përmasat praktike dhe metodologjike të urdhrave dhe udhëzimeve kur’anore. Muhamedit a.s., si i Dërguar i Zotit, iu desh të kryente një mision të katërfishtë për të përsëritur mesazhet e Kur’anit për njerëzit në përgjithësi dhe për pasuesit e tij në veçanti, saktësisht siç i mori ai ato nga Zoti.

Fabrikimi i traditave pejgamberike, fjalë për fjalë si dhe teknikisht, nënkupton atribuimin e një deklaratë ose praktike Pejgamberit Muhammed a.s. në mënyrë të gabuar *me* ose *pa* qëllim. Raportet që përmbajnë informacion në lidhje me thëniet ose veprimet e Muhammedit a.s., të cilat ai kurrë nuk i tha ose i bëri, refuzohen njëzëri si gënjeshtër, insinuata, shpifje. Studiuesit e hadithit kanë identifikuar thënie të ndryshme të përdorura në tradita, të cilat tregojnë për natyrën e tyre apokrifë, disa prej tyre padyshim që janë treguese të trillimit, ndërsa të tjerët i referohen fabrikimit në mënyrë metonimike. Kur autoritetet u referohen disa transmetuesve në një zinxhir transmetuesish, duke përdorur shprehje superlative, të ekzagjeruar ose të shka llës së thjeshtë.

Pozicioni i Muhammedit a.s. për besimtarët është ai i një gjykatësi (“Dhe jo, pasha Zotin tënd, ata nuk janë besimtarë derisa për gjykatës në mosmarrëveshjet e tyre nuk të pranojnë ty,

e pastaj për shkak të gjykimit tënd në shpirtrat e tyre nuk ndiejnë aspak peshë, dhe derisa të përulen plotësisht.” En-Nisa’, 65). Vendimet e tij janë përfundimtare (“Kur Allahu dhe i Dërguari i tij caktojnë diçka, atëherë as besimtari as besimtarja nuk kanë të drejtë të sillen sipas mënyrës së vet. Dhe kush nuk e dëgjon Allahun dhe të Dërguarin e tij ai me siguri ka humbur keq.” El-Ahزاب, 36). Autoriteti i tij përfaqëson autoritetin e Allahut (“Kush respekton të Dërguarin e ka respektuar edhe Allahun; kurse ai i cili kthen kryet në anë tjetër – ani, Ne nuk të kemi dërguar ty t’u bëhesh rojtar.” En-Nisa’, 80). Siç u theksua më herët, nën kriterin e parë, të Kur’anit, çështjet e diskutueshme duhet t’i referohen Allahut dhe të Dërguarit të Fundit Muhammedit a.s. I Dërguari a.s. e kreu misionin e tij për një periudhë prej rreth njëzet e tre vitesh përpara përmbushjes së tij përfundimtare. Gjatë kësaj kohe ai shpjegoi Kur’anin, mësoi se si t’i praktikonte urdhrat e Allahut në jetën e përditshme praktike, i udhëzoi pasuesit e tij në bindje e mendjethellësi.

Vërtetimi i hadithit përmes arsytimit të shëndoshë është temë thaujse e anatemuar. Edhe pse rryma të ndryshme dikur dhe sot, kundërshtojnë rolin e arsyes (el-akl), arsyeja luan një rol jetësor në ekzistencën e njeriut (“E kur atyre t’ju thuhet: ‘Ndiqeni Shpalljen (Kur’anin) e Allahut!’” Ata përgjigjen: “Jo! Ne ndjekim atë udhë, në të cilën i kemi gjetur të parët tanë” Vallë! Edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kanë ditur asgjë dhe kur nuk kanë qenë në rrugën e drejtë?!” El-Bekare, 170).

Është një fuqi që e ngre njerëzimin në pozicionin më të lartë në tokë (“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të caktojë përfaqësuesin në tokë” – Ata thanë: “A do të jetë përfaqësuesi yt ai që në të do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak? Ne të madhërojmë e të laudërojmë dhe të ngrisim ashtu si të takon Ty”. Ai tha: Unë di atë që ju nuk dini. Allahu ia mësoi Ademit të gjithë emrat

e pastaj atë ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Nëse e keni thënë të vërtetën, m’i tregoni emrat e këtyre sendeve”. “Qofsh i lavdëruar!” – thanë ata – “ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Ti je mendjemprehtë dhe i gjithëdijshtëm”. O Adem – tha Ai – tregoju emrat e tyre! – Kur ai u tregoi emrat e tyre, Allahu tha: “A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe vetëm Unë e di atë që tregoni haptazi dhe atë që e fshihni”. Kur u thamë engjëjve: “Përluni para Ademit” – ata u përulën, por Iblisi nuk deshi, ai e rriti mendjen dhe u bë i pafé. Ne thamë “O Adem të jetosh ti dhe gruaja jote në xhennet dhe të hani në të sa të doni dhe kur të doni, por mos iu afroni këtij druri sepse i bëni keq vetvetes. Shejtani për shkak të këtij druri i shtyri të gabojnë e t’i nxjerrë nga vendi ku ishin. “Zbritni – u thamë Ne – do të jeni armik i njëri tjetrit e në Tokë do të qëndroni dhe do të jetoni deri në afatin e caktuar”. Ademi dëgjoi disa fjalë (Urdhra) e i zbatoi nga Zoti i vet, Ai ia pranoi pendimin dhe i fali gabimin. Ai shumë i pranon pendimet, Ai është i mëshirshëm. Ne u kemi thënë: “Zbritni të gjithë prej (xhenetit të) tij. Juve me të vërtetë do t’ju vijë një dirigjues prej meje dhe ata që i përmbahen dirigjimit Tim nuk do të kenë frigë dhe nuk do të hidhërohen.” El-Bekare, 30–38) dhe përmes zbatimit të duhur ndihmon në ruajtjen e njerëzimit (“Ne ua kemi shpallur juve Librin, i cili është këshillë e lavdi për ju. Vallë, a nuk po kuptoni ju?” El-Enbija, 10). Keqpërdorimi, abuzimi ose mospërdorimi i saj shkatërron epërsinë e njeriut mbi shumicën e krijesave të tjera (“Krijesat më të këqija tek Allahu janë ata që shtiren shurdhmemecë, e as që duan të kuptojnë.” (El-Enfal, 22) Ndërsa pezullimi total i arsytimit të pavarur e rrëgon atë në gjendjen e kafshëve (“Ne kemi krijuar shumë njerëz dhe xhinë për ferr. Ata kanë zemër, por me to nuk kuptojnë, ata kanë sy, por me ta nuk shohin, ata kanë veshë, por me ta nuk dëgjojnë; ata janë sikur kafshët, madje edhe më të humbur; ata janë neglizhentë.” El-A’raf, 179). Kur’ani vë theks të madh te fuqia intelek-

tuale e njeriut, e tillë që besimi i vërtetë dhe veprat e mira duken të jenë të pamundura pa udhëheqjen e arsyes (“Dhe do të thonë: ‘Të kishim dëgjuar dhe të kishim pasur mend, nuk do të ishim në mesin e banorëve të flakës’.” El-Mulk, 10).

Studimi i historisë është thelbësor dhe një nga qëllimet e saj më parësore është roli edukues. Më shumë sesa një paraqitje e thjeshtë e ngjarjeve të së kaluarës, historia duhet të jetë idealisht një udhëzues për të ndihmuar njerëzimin të korrigjojë gabimet që mund të ketë bërë më herët dhe për të marrë frymëzim nga më të mirat që mund të ketë arritur. Kur’ani paraqet historinë në këtë mënyrë dhe në maskën e një mësuesi. Si Kur’ani, ashtu edhe Bibla, përshkruajnë historinë e shumë popujve dhe individëve.

Islami është fe dhe mënyrë e baraspeshuar e jetës, në përputhje të plotë me natyrën njerëzore, e cila tenton të preferojë atë që është e moderuar dhe të refuzojë ose të mos pëlqejë atë që është e moderuar. Rregullat e tij pasqyrojnë parimin e ekuilibrit në të gjitha gjërat dhe gjithçka që i atribuohet Islamit, e cila duket se është ose ekzagjerim ose ekstrem, nuk është pjesë origjinale e besimit. Kur’ani i quan ithtarët e mesazheve të Allahut si një *ummeten vesaten* (ose një popull i drejtpeshuar) (Shiko: El-Bekare, 143).

Imam Buhariu është njëri nga studiuesit më të respektuar të haditheve në historinë muslimane dhe ndoshta më i famshmi. Sahihu i tij gjithashtu konsiderohet gjerësisht nga shumë studiues si libri më autentik pas Kur’anit. Pa dyshim, *El-Xhamiu’s-Sahih* ka ushtruar ndikim të madh në mendjen dhe jetën e muslimanëve. Vepra lexohet gjerësisht dhe referohet në të gjithë botën muslimane si një burim i të drejtës islame, por edhe besimit, etikës etj. Një prej kapitujve që është trajtuar në veprën e përkthyer është edhe tema e kaderit (paracaktimit, determinizmit). Autori vë në pah disa hadithe kundërthënëse, sikur edhe në temat tjera, duke

theksuar se vërtetësia e haditheve duhet të bëhet jo vetëm sipas kriterit të zinxhirit transmetues (senedit), por edhe sipas tekstit (metnit).

Mendojmë se autori ka bërë një vepër të vlefshme, kritike, avangarde të llojit, edhe pse disa hollësi profesionale mund ta bezdisin lexuesin e zakonshëm.

Përkthyesi, zotëri Arjol Guni, gjithashtu ka arritur ta përkthejë dhe zbërthejë veprën për ta kuptuar lexuesi shqiptar pa vështirësi. Këtë punë e ka përfunduar me sukses edhe botuesi Logos-A dhe stafi i tij. Çdo lëvdatë!

Botuesi

Mirënjohje

Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut. Vetëm Atij i detyrohem për këtë vepër. Ai donte që unë duhet të kisha vullnet për ta shkruar këtë libër dhe në sajë të mëshirës së Tij të pafundme unë e pata atë vullnet. Allahu, pra, më ndihmoi që të arrija ta shkruaja deri në fund këtë libër.

Falënderimet e mia qofshin për *The Research Management Centre, International Islamic University Malaysia* (IIUM) (Qendra e Administrimit Kërkimor, Universiteti Ndërkombëtar Islam i Malajzisë) që sponsorizoi projektet e mia hulumtuese, të cilat tanimë janë kapitulli i tretë, i katërt, i pestë, i gjashtë dhe i tetë i këtij libri. U shprehë mirënjohjen time të thellë Dekanit, Zv. Dekanëve, Drejtorëve, Ndihmës-/Drejtorëve dhe zyrtarëve të tjerë të universitetit për ndihmën e tyre bujare dhe të shpejtë që më nevojitej për përfundimin e këtyre projekteve kërkimore.

Profesori i Asociuar, Dr. Hazizan M. Noon, Dekan i Fakultetit të Dijes së Shpallur Islame dhe Shkencave Humane, IIUM, meriton falënderimet e mia së pari për miratimin e propozimit tim kërkimor dhe së dyti që më ka frymëzuar të vazhdojë hulumtimin tim mbi këtë temë.

Profesor Dr. Muhammad Nejatullah Siddiqi, Profesor Dr. Ibrahim M. Zain, Profesor i Asociuar Dr. Jamal Basheir Badi, dhe Dr. Muhammad Tahir Mesawi' të cilët më inkurajuan, më këshilluan dhe ndanë me mua pikëpamjet tyre mbi veprën time. Të gjithë atyre u jam jashtëzakonisht mirënjohës.

Dr. Jamal Barzinji, Nën-President i Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam (IIIT USA), më frymëzoi jashtë

mase me gatishmërinë e tij për ta botuar këtë vepër. Allahu e begatoftë atë!

Gruan time, Shahnaz Begum, katër vajzat e mia, Mariya Seemin, Juwayriya Naznin, Naeylah Zarrin, Hamnah Sheerin dhe pesë djemtë e mi, Muaaz, Muawwiz, Yasir, Samrah dhe Owaym. Ata të gjithë më kanë mbështetur përgjatë detyrës sime të vështirë si me fjalë ashtu dhe në praktikë, duke u treguar të durueshëm dhe duke më inkurajuar, pa më lënë as barrën më të vogël dhe duke më mbrojtur nga çdo trysni, qoftë e mbrapshtë apo e çdo natyre tjetër, që mund të kishte ndikim mbi veprën time. Unë i lutem Allahut që ata të kenë mirëqenie në këtë botë dhe në amshim. Amin!

Përdorimi i fjalës “traditë” për të treguar hadithin dhe sunetin


Lexuesit do të vënë re se autori shpesh ka përdorur fjalën “traditë/traditat” në vend të termave më të njohur që vijnë nga arabishtja, hadith dhe sunet. Lexuesit e përgjithshëm mund të ndihen paksa të pështjelluar me këtë përdorim por ky është një konvencion që është adoptuar si nga dijetarët muslimanë të hadithit ashtu dhe ata orientalistë.

Më tutje, Universiteti Ndërkombëtar Islam i Malajzisë (IIUM), i cilësuar si pionier në prezantimin e shumë disiplinave fetare në gjuhën angleze, siç është rasti i Studimeve të hadithit, e përdor rëndom këtë term për të nënkuptuar hadithin dhe sunetin.

Fjalorët e gjuhës angleze, për më tepër, e përkufizojnë termin “traditë” në mënyrë të ngjashme në këtë kontekst, për shembull, “(në Islam) një thënie apo akt që i mvishet Të Dërguarit, por që nuk është e regjistruar në Kur’an. Shiko HADITH” (*The New Oxford Dictionary of English*, Oxford: Clarendon Press, 1998.)

Së fundi, disa fjalorë anglisht-arabisht e përkufizojnë “traditën” si *El-Hadith ‘ush-Sherif* (p.sh. Munir Ba’labeki, *Al-Mawrid*, Bejrut: Dar ‘ul-Ilm li ‘l-Melajin, 1998).

Hyrje



Bism'il-lah'ir-Rrahman'ir-Rrahim

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që Ti na e mësove.”

(Kur’ani, El-Bekare /2:32)

Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) paraqet këtë vepër studimore mbi temën Autentifikimi i hadithit: ripërkufizimi i kriterëve, për të hedhur dritë të re mbi çështjen e trillimit apo shpikjes në Hadith.

Israr Khan trajton temën sensitive të autentifikimit (vërtetimit) të haditheve, duke u fokusuar mbi kriteret e adoptuara nga hartuesit e përmbledhjeve kryesore për të argumentuar se përqendrimi mbi vazhdimësinë dhe saktësinë e zinxhirit të transmetuesve dhe jo mbi përmbajtjen tekstuale të hadithit, ka bërë që në to të jenë përfshirë hadithe të caktuara që ose bien drejtpërdrejt ndesh me hadithe të tjera, ose e projektojnë Pejgamberin s.a.v.s.¹ në një dritë jo karakteristike, ose që nuk pasqyrojnë dhe/ose bien ndesh me mësimet e Kur’anit. Krahas kësaj, ai pohon, duke pasur parasysh masën e madhe të traditave që qarkulluan menjëherë mbasi Pejgamberi ndërroi jetë, se do të ishte e pamatur po të injorohej fakti se shumë prej tyre përmbanin falsifikime të bëra enkas. Këto jo vetëm që kishin për qëllim

¹ *Sal-Ilal-Ilahu alejhi ve sel-lem*. Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të. Thuhet sa herë që përmendet emri i Pejgamberit Muhamed a.s.

të korruptonin dhe kalbëzonin kumtin thelbësor të fesë, por gjithashtu të fuqizonin tendenca të caktuara politike, sektare, ekonomike dhe madje edhe teologjike. Dallimet politike si edhe fetare, të motivuara gjerësisht prej rivalitetit karshi fesë ende të re, çuan drejt një fushate të pandërprerë dhe të mirënjohur dezinformimi, duke përdorur mjetin e hadithit.

Ndonëse keqpërdorimi dhe abuzimi i hadithit nuk është aspak i ri, në botën e sotme komplekse dhe të paqëndrueshme pasojat e të mbështeturit mbi hadithet mashtruese dhe të sajuara për të legjitimizuar sjelljen ekstremiste, për të justifikuar abuzimin e hapur, sidomos të grave, dhe për të lëshuar fetva trazuese, që bëjnë thirrje për akte të dhunshme, jo vetëm që është tejet i lehtë, por faktikisht edhe tejet i rrezikshëm. Krahas kësaj, duke pasur parasysh përhapjen e gjerë të ndjesive anti-islame që aktualisht dominojnë në diskursin *mainstream*, është e domosdoshme që të trajtohet edhe çështja e haditheve të trilluara, të reklamuar gjerësisht dhe të shfrytëzuara në mënyrë të paskrupullt për të mbështetur tezën e dhunës dhe prapambetjes islame. Për rrjedhojë, është përgjegjësi e dijetarëve muslimanë të cilët janë të kënduar e të ditur në lëmitë islame që të çrrënjosin me ndershmëri dhe kurajo ato hadithe që duket qartë se janë të trilluar dhe të cilët jo vetëm që ndjellin një interpretim kallëp, por gjithashtu përjetësojnë injorancën duke tradhëtuar kësodore si Kur'anin ashtu edhe Pejgamberin.

Çdo studim serioz mbi përmbajtjen dhe shtrirjen e këtyre traditave duhet t'ia nisë domosdoshmërisht nga fillimi, në këtë rast mbas vdekjes së Pejgamberit Muhamed a.s. Autori gjurmon në hollësi të saktë dhe të kujdesshme zhvillimin historik të traditave gojore dhe të shkruara, si edhe shumë përpjekje që kanë pasur për synim fabrikimin që ka ndodhur, duke kritikuar në hollësi metodike hadithe të caktuara që pranohen gjerësisht si "autentikë". Në çdo çështje të debatit

në lidhje me hadithin, arbitri final duhet të jetë Kur'ani. Si i tillë, vëren autori, çdo hadith që duket se bie ndesh me Kur'anin duhet të shqyrtohet me kujdes dhe me saktësi, dhe në qoftë se nuk gjendet asnjë interpretim për të zgjidhur kontradiktën, atëherë hadithi në fjalë duhet refuzuar. Më tutje akoma, duke qenë se Muhamedi a.s., i Dërguari i Fundit që iu dërgua të gjithë njerëzimit, interpretimet si të Kur'anit ashtu dhe të Hadithit nuk duhet të nguliten në kohë, por më saktë duhen shqyrtuar me kujdes dhe të riinterpretohen për të dhënë udhëzim praktik që plotëson kërkesat dhe sfidat e një epoke të re, domethënë, që merr parasysh faktorin kohë-hapësirë. Është pikërisht këtu që shkenca e "*makasid 'ush-sheriah*", ose synimet dhe qëllimet e larta të shariatit apo ligjit islam, hyn në lojë si zemra dhe filozofia e të Drejtës Islame.

Kështu që, për t'iu përgjigjur pyetjes së vështirë nëse ka ndonjë nevojë të vërtetë për hulumtim në autentifikimin e hadithit, ne lypset të përgjigjemi në mënyrë realiste dhe në gjurmët e traditës më të mirë skolastike të Islamit, me një "po". Ndjekja e saktësisë më të madhe nuk ka kurrësi për qëllim që të rrënojë themelet e besimit të muslimanëve të Shkenca e Hadithit. Kurrën e kurrës! Është pikërisht nga hadithi, pohon autori, prej nga ku jeta e Pejgamberit Muhammed është marrë nga kujtesa dhe është sjellë në jetë, prej nga ku janë kodifikuar format e mëdha të adhurimit dhe lutjes islame, dhe janë shtruar themelet e Sunetit. Krahas kësaj, përmbledhjet e spikatura që ne kemi sot, u bënë të mundura nga zhvillimi i shkencës së kritikizmit të hadithit, dhe dijetarët muslimanë meritojnë një vlerësim të thellë jo vetëm për punën e tyre të palodhur, por gjithashtu edhe për kontributin e tyre të paçmuar për të bërë çmos për konservimin e literaturës së hadithit. Megjithatë, këmbëngul autori, procesi është i pandërprerë dhe politika e dyerve të mbyllura, që duket se rrethon autentifikimin e hadithit sot, ka nevojë për

një rishqyrtim të kujdesshëm dhe sistematik. Është pikërisht në këtë frymë që autori në *Autentifikimi i hadithit* orvatet që të ripërkufizojë kriteret e përdorura për të kontrolluar hadithet, dhe më pas ua zbaton këto kritere disa haditheve të caktuara që janë mbajtur shënim. Vepra e tij i ka shtuar një dimension të çmuar dhe të dobishëm bashkëkohor dhe ditunor studimit të literaturës së hadithit.

Ky studim është botuar për të zgjeruar diskutimin, për të ftuar studiuesit që të përgjigjen, dhe me shpresë që të shtrojë udhën për hulumtime të mëtejshme. S'ka dyshim se lexuesit mund të pajtohen me një pjesë të problematikave të ngritura nga autori, dhe gjithashtu mund të mos jenë aspak dakord me të tjera sosh, por ajo që shpresohet është se për pjesën më të madhe si lexuesit e përgjithshëm ashtu dhe ata të specializuar do të përfitojnë nga perspektiva e ofruar dhe problemet e përgjithshme që janë shqyrtuar në këtë libër.

Që nga themelimi në vitin 1981, IIIT ka vijuar që të shërbejë si një qendër madhore për të lehtësuar përpjekjet e singerta dhe serioze ditunore dhe akademike, bazuar mbi vizionin, vlerat dhe parimet islame. Programet e tij të punës kërkimore, seminarit, dhe konferencat, gjatë njëzet e tetë viteve të fundit, kanë rezultuar në publikimin e më shumë se katërqind titujve në anglisht, arabisht dhe në gjuhë të tjera kryesore.

Ne do të donim që të shprehnim falënderimet tona për grupin editorial dhe të prodhimit në Zyrën e Londrës IIIT dhe për të gjithë ata që kanë qenë drejtpërdrejt apo tërthorazi të përfshirë në përfundimin e kësaj vepre. Ne gjithashtu do të donim të shprehnim falënderimet tona për autorin, i cili, përgjatë etapave të ndryshme të prodhimit, ka bashkëpunuar ngushtë me ekipin editorial.

Zyra e Londrës IIIT

Muharrem 1431 h./ Janar 2010

Parathënie

Statusi dhe rëndësia e hadithit në Islam

Sistemi islam i besimit, mendimit, veprimtarive jetësore, rendit social, rregullave ekonomike, rregullimeve politike, caqeve kulturore, parimeve morale, normave edukative, kodeve intelektuale dhe ligjeve fetare është i gjithi i qeverisur nga Kur'ani dhe Hadithi. Kur'ani paraqet saktësisht fjalët e shpallura të Allahut s.v.t.² dhe hadithi përbën dimensionet praktike dhe metodologjike të urdhërave dhe porosive kur'anore.

Pejgamberi Muhamed, si i Dërguari i Zotit, duhej të mbartte një mision të katërfishtë (El-Xhumu'a /62:2):

1) t'ua përsëriste porositë e Kur'anit njerëzve në përgjithësi dhe ndjekësve të tij në veçanti, saktësisht ashtu siç ai i merrte ato nga Zoti;

2) të transformonte të gjithë popullin e Arabisë, konceptualisht si edhe nga pikëpamja e sjelljes; 3) të shpaloste të vërtetën e shpallur në Kur'an dhe;

4) të demonstronte praktikisht parimet kur'anore në jetën e tij dhe atyre që hynin në vathën e tij t'ua mësonte fenë e tij. Për këto përgjegjësi të rënda dhe të shumëfishta, ai kishte nevojë për udhëzimin e Zotit, dhe atij iu garantuan dy gjëra, Kur'ani dhe *Bejan*-i i tij, që është shpjegimi apo kuptimi i tij:

Ti mos e lëviz gjuhën tënde me ngut [duke përsëritur fjalët e shpalljes:] sepse Ne e kemi për detyrë tubimin e tij [në zemrën tënde], dhe ta bëjmë atë që të lexohet [sikurse i ka

² *Subhanehu ve Teala*: Lavdëruar qoftë Ai dhe u lartësoftë transhendenca e Tij.

hije të lexohet]. Kësisoj, kur Ne ta lexojmë ty atë, ti ndiq formulimin e tij [me të gjithë mendjen tënde]: dhe, më pas, do të jetë obligimi Ynë që ta bëjmë kuptimin e tij (*bejanehu*) të qartë. (El-Kijameh /75:16-19).

Kur'ani përmban saktësisht fjalët e shpallura të Allahut dhe *Bejan* është demonstrimi i Kur'anit nga Pejgamberi. *Bejan*-i i Kur'anit është ajo çfarë njihet në trashëgiminë islame si Hadith dhe Sunet. Statusi i Hadithit dhe Sunetit në jetën islame është faktikisht pozicioni i Pejgamberit, që do të thotë se sot, kur ne flasim për Hadithin dhe Sunetin, ne faktikisht merremi me Pejgamberin. Pejgamberi ka mbajtur pozita të caktuara, siç janë gjykatës final, udhërrëfyes, etj... dhe duke qenë se ai nuk është më me ne, thëniet dhe veprat e tij do të vështrohen nga po i njëjti kënd.

- Bekimet e Allahut mbulojnë ata të cilët u binden Allahut dhe Pejgamberit të Tij (Alu Imran /3:132).

- Bindja ndaj tij është detyrë e ndjekësve të tij (En-Nisa' /4:59).

- Ai është gjykatës në të gjitha mosmarrëveshjet e jetës (En-Nisa' /4:65).

- Indiferenca e qëllimshme në bindjen ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij përbën një shkelje të rëndë (El-Enfal /8:12-25).

- Shmangja e udhëzimit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij përfundimisht çon në dështim në jetë (El-Enfal /8:46).

- Shpërfillja e porosive të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij bën që veprat e njeriut të bëhen të pakuptimta (Muhammed /47:33).

Qasja e muslimanëve bashkëkohorë ndaj hadithit

Në terma të qasjes së tyre ndaj hadithit, muslimanët mund të klasifikohen në katër kategori:

1) Ata të cilët e refuzojnë tërësisht rëndësinë e hadithit në jetën islame.

2) Ata të cilët pranojnë verbërisht çdo gjë që duket se është hadith, pavarësisht nga autenticiteti i saj.

3) Ata të cilët bëjnë një përzgjedhje pa bërë asnjë dallim nga hadithet për qëllime praktike.

4) Ata të cilët besojnë në shenjtërinë e traditave pejgamberike por zgjedhin një qasje jashtëzakonisht të kujdesshme sa i përket rëndësisë së tyre logjike dhe praktike për jetën dhe civilizimin islam.

Nga të gjitha kategoritë, ata që janë në të katërtën duket se janë më paanësisht të ekuilibruarit midis ekstremeve. Për ata në kategorinë e parë, refuzimi total i hadithit si një burim i rëndësishëm i vlerave jetësore islame është në konflikt të plotë me deklaratimet e vet Kur'anit. Në një numër vendesh në Kur'an, Allahu i urdhëron besimtarët: "Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit" (p.sh., En-Nisa /4:59). Bindja ndaj Allahut do të thotë që të ndjekësh porositë që përmban Kur'ani; dhe bindja ndaj Pejgamberit sinjifikon të vepruarit në bazë të modelit metodologjik të jetës që gjendet i gdhendur në traditat autentike të Pejgamberit. Përmendja e njëkohëshme në Kur'an e të dyja tipeve të bindjes – ndaj Allahut dhe Pejgamberit – nuk mund të interpretohet kurrësi se nënkupton bindje vetëm ndaj Allahut, siç pretendojnë ata që mohojnë hadithin. Refuzimi total i Sunetit dhe Hadithit, mund të rezultojë vetëm në shndërrimin e Islamit në një filozofi të thjeshtë që është e cënueshme nga variacionet në interpretimin e tij. Shpesh pretendohet se gjendja e mjerueshme e muslimanëve sot ka ardhur për shkak të religjiozitetit të tyre të stereotipizuar, megjithatë, madje edhe në qoftë se kësaj linjë argumenti i jepet ndonjë konsideratë serioze, suneti dhe hadithi nuk mund të mbahen përgjegjës. Përkundrazi, muslimanët nuk po vuajnë për shkak të ndonjë respektimi rigoroz të traditave të vjetra të Pejgamberit, por më saktë për shkak se janë larguar si nga Kur'ani ashtu dhe nga suneti në mendimet dhe praktikat e tyre.

Në kundërvënien me ata të cilët e mohojnë totalisht vlefshmërinë e hadithit janë ata të cilët kanë një dashuri të pakushtëzuar për të dhe për sunetin, dhe përgjithësisht si muslimanë gjysmë të lexuar që janë, të cilët janë të keqduhëzuar dhe të cilët, për rrjedhojë, keqduhëzojnë shumë të tjerë, ata i qëndrojnë besnikë gjithçkaje që përkufizohet traditë pejgamberike, pavarësisht nga autenticiteti i traditave të përcjella në burime. Krahas kësaj, në qoftë se do të kryhej një anketë mbi traditat pejgamberike që janë mjaft popullore në gjirin e muslimanëve sot, gjetjet mund të ishin tronditëse, sepse në qarqet fetare rrefehen, interpretohen dhe praktikohen një numër i madh i traditave të tilla dhe ato trajtohen sikur të ishin të vërteta, në një kohë që në realitet ato janë pak a shumë mbetje të traditave të trilluara në emër të Pejgamberit. Kësodore, ky është njëri ndër faktorët kryesor në sfond të prapambetjes dhe rënies muslimane praktikisht në çdo fushë të jetës, përfshirë këtu edhe atë fetare e shpirtërore.

Popujt e Shkrimeve të Shenjta të mëparshme janë kritikuar në Kur'an për trajtimin pa entuziazëm që ata i kanë bërë atyre (El-Bekare /2:85) si edhe për shpërfilljen ndaj urdhëresave të pejgamberëve të tyre (El-Maide /5:20-24). Madje edhe hipokritët, gjatë kohës së Pejgamberit, janë qortuar në Kur'an për qasjen e tyre selektive ndaj Shpalljes dhe porosive të Pejgamberit (Fussilet /41:150). Në botën muslimane sot ka njerëz të cilët zgjedhin vetëm ato ajete kur'anore dhe vetëm ato tradita pejgamberike të cilat u bëjnë dobi në një mënyrë apo një tjetër interesave të tyre të ngushta dhe agjendave të tyre të fshehta. Kur'ani u referohet këtyre muslimanëve si ata në zemrat e të cilëve ka sëmundje, të cilët nuk janë të sinqertë ndaj Islamit apo kauzës së tij. Një qasje tejet e balancuar ndaj Kur'anit dhe sunetit e hadithit duket se është e vetmja qasje e suksesshme që mund të ndërmerret, sikurse rekomandohet kjo në

Kur'an (El-Bekare /2:143). Një qasje e balancuar ndaj Sunetit e Hadithit tregon një besim në vetëm ato tradita të Pejgamberit që janë tej mase autentike dhe përtej çdo dyshimi çfarëdoqoftë, si edhe praktikimin e tyre.

Autenticiteti i sunetit dhe hadithit

Shkrimet islame, si të vjetra ashtu dhe të reja, gëlojnë nga literatura e sunetit dhe hadithit, testament ky i rëndësisë së madhe të këtyre temave. Përmbledhjet e hadithit mund të klasifikohen përgjithësisht në katër kategori sipas rangut të autenticitetit të tyre:

1) Ato përmbledhje të hadithit që pretendohet se janë veprat më autentike, siç janë ato të Buhariut dhe Muslimit.

2) Ato përmbledhje që përmbajnë vetëm disa pak transmetime të dyshimta, siç janë ato të Tirmidhiut, Nesaiut dhe Ebu Davudit.

3) Ato përmbledhje që përmbajnë shumë tradita problematike, siç janë ato të Ibn Maxhes dhe Ahmedit.

4) Ato përmbledhje që kanë shumë tradita të dobëta dhe të trilluara, siç është ajo e Taberaniut.

Autenticiteti i hadithit sikurse pretendohet nga autoritetet e hadithit varet krejtësisht nga autenticiteti i zinxhirit të transmetuesve që raportojnë hadithet. Vështirë se i kush-tohet ndonjë vëmendje serioze autenticitetit të haditheve nëpërmjet vërtetimit të tekstit të hadithit.

Vërtetimi i tekstit të hadithit

Dijetarët dhe studiuesit muslimanë besojnë se nëse zinxhiri i transmetuesve i një hadithi përmbush pesë kritere – vazhdimësia në zinxhirin e transmetimit (*ittisal 'us-sened*), integriteti i karakterit (*'adaleh*), memorizimi i pagabueshëm (*dabt*), mungesa nga çdo e metë e fshehtë (*gajr 'ul-'il-leh*) dhe paprekshmëria nga ndonjë aberracion apo lajthitje (*'adm 'ush-*

shudhudh) – hadithi duhet të pranohet si autentik. Dy kriteret e fundit janë gjithashtu të zbatueshme ndaj shqyrtimit të tekstit të një hadithi. Megjithatë, në praktikë kjo mbetet e kufizuar vetëm në debatet dhe diskutimin e veprave të ‘*Ulum ‘ul-Hadithit*, dhe hartuesit e përmbledhjeve të haditheve rrallëherë i kanë akomoduar ato në shqyrtimin që ata i kanë bërë tekstit të hadithit. Disa dijetarë, në një stad të mëvonshëm të historisë islame, kanë sugjeruar shqyrtimin e haditheve nga një kënd tekstual, por thirrja e tyre ka rënë në veshë të shurdhët.

A ka ndonjë nevojë reale për vërtetimin e hadithit nga një kënd tekstual? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është sa e vështirë po aq edhe e thjeshtë. E vështirë për shkak se dijetarëve të hadithit sot u mungon kurajoja që lypset për t’iu përgjigjur asaj, dhe e thjeshtë për shkak se arsyet që përligjin shqyrtimin e hadithit nga këndi tekstual janë të shumta.

1. Polemika mbi pozicionin e një transmetuesi të veçantë

Është e mirënjohur se dijetarët e hadithit nuk janë të gjithë unanimë mbi besueshmërinë e disa transmetuesve, dhe shembuj të kësaj mund të gjenden në fjalorët biografikë. Për shembull, në lidhje me një transmetues të veçantë, vëzhgimi i Muslimit ndryshon nga ai i Buhariut; një ekspert i biografive pretendon se një transmetues është i besueshëm (*thikkah*), ndërkohë që një tjetër e sheh atë si të dobët (*da’if*), ndërsa një autoritet i tretë mund të dalë në përfundimin se nuk ka gjetur asnjë problem tek ai (*la be’se bihi*)! Si duhet vepruar dhe reaguar në një situatë të këtillë?

2. Paaftësia e disa transmetuesve për të ruajtur saktësinë e transmetimit

Pothuajse të gjithë dijetarët e hadithit janë të pikëpamjes se pjesa më e madhe e traditave pejgamberike nuk janë treguar me fjalët e Pejgamberit, por në termat e kuptimit të

mesazhit. Liria për të përcjellë thëniet pejgamberike në terma të kuptimit nuk është krejt pa probleme, dhe, sikurse do të tregojë kjo vepër aktuale që keni në dorë, transmetues të caktuar nuk kanë mundur që ta ruajnë këtë. Shembulli i mëposhtëm, sikurse citohet nga Zerkeshiu në veprën e tij monumentale *El-Ixhabeh*, është ilustruese e kësaj dukurie në lidhje me dy ezanët, që don të thotë thirrjen për në namazin e sabahut në muajin e Ramazanit, njëri i kënduar nga Bilali dhe tjetri nga Abdullah ibn Um Mektumi: Abdullah Ibn Omeri ka thënë se Pejgamberi a.a. tha: “Bilali e thërret ezanin ndërkohë që është ende natë; ju mund të vazhdoni së ngrëni e së piri deri kur ezanin të vijë ta thërrasë Abdullah ibn Um Mektumi.” Aishja e fajësoi Ibn Omerin se e kishte përcjellë thënien pejgamberike në mënyrë të gabuar. Ajo e korrigjoi thënien dhe shtoi se Pejgamberi tha: “Ibn Um Mektumi është i verbër kur thërret ezanin për në namaz, vazhdoni të hani e të pini derisa ezanin ta thërrasë Bilali.” Këtu mund të sugjerohet se Buhariu ka mbajtur shënim dy transmetime mbi të njëjtën temë, njëri me autoritetin e Ibn Omerit dhe tjetri me autoritetin e Aishes; dhe të dyja transmetimet janë të njëjta, prandaj del se korrigjimi që Aishja i ka bërë Ibn Omerit duke i paprovuar. Kështu duket, në fakt, por ka transmetime të tjera me autoritetin e Aishes dhe të tjerëve siç është regjistruar kjo në vepra të tjera të hadithit, sikurse janë ato të Ahmed ibn Hanbelit dhe Bejhakiut, të cilat mbështesin pikëpamjen e Zerkeshiut, sikurse përmendet më sipër. Duhet mbajtur parasysh se transmetimet me autoritetin e Aishes mbi këtë çështje, siç ato janë mbajtur shënim në burime të tjera përveç Buhariut, janë pa dallim fort autentike nga këndi i zinxhirit (*sened*). Sipas Zerkeshiut, Aisha gjithashtu vërejti se Bilali mund ta pikaste mirë kohën për namazin e sabahut dhe Abdullah ibn Um Mektumi për shkak të verbërisë së tij

nuk ishte në një pozitë që të përshquante kohën e saktë. Ky justifikim racional sugjeron se një transmetues në zinxhirin e transmetimit të Buhariut mund të ketë gabuar dhe ka përmbysur rendin e emrave, gjegjësisht Bilal dhe Ibn Um Mektum.

3. Konfliktet tekstuale në gjirin e transmetimeve

Qoftë kur marrim në shqyrtim përmbledhjen e haditheve të Buhariut apo atë të Muslimit, ka disa raste ku transmetime të caktuara që kanë të bëjnë me të njëjtën çështje ndryshojnë nga njëri tjetri, jo vetëm në fjalë por edhe në kuptim gjithashtu. Në përgjithësi sugjerohet se diferenca të tilla në transmetim janë jo për shkak të gabimeve nga ana e transmetuesve, por për shkak se vetë Pejgamberi a.s. i ka shprehur thëniet ndryshe në raste të ndryshme. Ky parim mund të jetë i vërtetë në disa raste, por nuk është relevant çdokund. Për shembull, në kapitullin e tij mbi *El-Musakat* (marrjen me qira të tokës kundrejt një hiseje nga të korrat), Muslimi ka mbajtur shënim pesëmbëdhjetë hadithe mbi humbjen shpirtërore që mund të sjellë zbutja e qenëve, shtatë me autoritetin e Abdullah ibn Omerit dhe tetë të tjera me autoritetin e Ebu Hurejres (Muslimi: 3999-4013). Nga shtatë hadithe të përcjella me autoritetin e Ibn Omerit, pesë sosh na vënë në dijeni për zbritjen e përditshme prej dy karatë (*kiratan*) nga veprat e atij që mban qenin si kafshë shtëpiake pa ndonjë qëllim të mirëfilltë, por dy prej tyre i referohen zbritjes prej vetëm një karati të vetëm (*kirat*). Nga tetë hadithe të përcjella me autoritetin e Ebu Hurejres, vetëm njëri përmend zbritjen e dy karatëve të veprave të mira, ndërkohë që shtatë të tjerët thonë se zbritja është prej vetëm një karat. Si mund të zgjidhet mospërputhja dhe a ka ndonjë mënyrë që të vendoset një kompromis ndërmjet tyre?

4. 'Iluzioni' i transmetuesve të besueshëm

Ka raste kur zinxhiri i transmetuesve është jashtëzakonisht autentik, por ekziston ndonjë problem i qartë në tekstin e transmetimit. Në këtë situatë, në vend se të shqyrtojnë çështjen me kujdes, komentatorët e hadithit e vendosin menjëherë fajin mbi njërin prej transmetuesve pa e përmendur me emër, duke vërejtur se ai duhet të ketë patur ndonjë keqkuptim/keqkonceptim, apo iluzion (*kad vehime*), duke e lënë çështjen me kaq. Ata parapëlqejnë të mos e shqyrtojnë tekstin si një burim të mundshëm të pabesueshmërisë apo defektit, dhe përse është kështu dhe arsyeja më e mundshme përse ata dështojnë që ta bëjnë këtë është për shkak se ata nuk shohin asnjë problem në zinxhirin e transmetuesve. Faktikisht, në qoftë se ata gjejnë ndonjë problem në tekst, ai problem duhet të deklarohet si i tillë. Në qoftë se pikaset iluzion nga ana e një transmetuesi, cili është kriteri për ta përcaktuar këtë? Duhet të ekzistojnë disa kritere për të identifikuar defektin në tekst.

5. Korrigjimi praktik i transmetimeve

Që gjatë kohës së Shokëve të Nderuar, apo Sahabëve, transmetimeve të haditheve pejgamberike iu kushtua një vëmendje serioze, sidomos sa i përket saktësisë së tyre. Kapitulli i tretë dhe i katërt do të ilustrojnë se si disa thënie të Pejgamberit që janë transmetuar në mënyrë korrekte janë korrigjuar më vonë nga ata që ishin në ballë të dijes islame. Shembulli i mëposhtëm e demonstroi këtë problematikë mjaft mirë: "Ai që ka vdekur do të ringjallet me petkat që ka mbajtur veshur në kohën e vdekjes." Kjo thënie u korrigjua menjëherë nga Aishja e cila tha se Pejgamberi përmendi fjalën 'vepër', dhe jo 'petkë'. Ajo, më pas, argumentoi me ndihmën e një tjetër hadithi të Pejgamberit që thotë se: "Njerëzit do të ngrihen të zhveshur, të zbathur,

dhe të pabërë synet (jo-rrethprerë)” (*el-Ixhabeh*: 120). Ky korrigjim u bë në tekst. A duhet të lejohet që punët të vijojnë kështu po të kemi parasysh pështjellimin dhe problemet që kjo krijon?

6. Të identifikuarit e rëndësisë bashkëkohore të hadithit

Kur’ani dhe hadithi ngërthejnë në vetvete mësimet e Pejgamberit dhe kanë pasur për qëllim zbatimin praktik në jetën tonë të përditshme, jo thjesht për t’u mbështetur pa vepra. Duke qenë se Muhamedi ishte Pejgamberi i Fundit që iu dërgua njerëzimit, mësimet e tij gjithëpërfshirëse janë relevante për çdo person, kohë, vend dhe situatë. Për rrjedhojë, interpretimet si të Kur’anit ashtu dhe të hadithit nuk duhen fiksuar në kohë, por duhen shqyrtuar dhe riinterpretuar me kujdes për të dhënë udhëzime praktike që plotësojnë kërkesat dhe sfidat e një epoke të re, pra, faktori hapësirë-kohë. Në procesin e të bërit të kësaj gjëje, pa dyshim që do të ndeshen interpretime të ndryshme që janë avancuar tashmë prej komentatorëve të hadithit, dhe këto interpretime, herë herë, mund të jenë reciprokisht kontradiktore. Për ta kapërcyer këtë dhe për ta shmangur pështjellimin, mënyra më e mirë për të ecur përpara do të ishte që të shqyrtohej rishtazi pozicioni i fjalëve të përdorura në tekstin e traditave pejgamberike.

7. Të kuptuarit e dimensionit metodologjik të Hadithit

Traditat pejgamberike mund të klasifikohen në dy kategori kryesore, legjislativë dhe jo-legjislativë, me të parat që janë të detyrueshme për t’u respektuar dhe të dytat jo. Sa u përket traditave të detyrueshme për t’u respektuar, pozicioni i tyre duhet parë në raport me Kur’anin, arsyen dhe *Sunnetin Mutevatire* (domethënë, një hadith që transmetohet nga një numër kaq i madh njerëzish saqë prej tyre nuk pritët që

ata të jenë pajtuar të gjithë së bashku për një gënjeshtër). Ka një gjasë që Hadithi dhe Kur’ani mund të kundërshtojnë njëri tjetrin, rast ky në të cilin dijetarët lypset që të bëjnë përpjekje për të gjetur një kompromis në mesin e traditave kundërthënëse. Në qoftë se kjo nuk është e mundur, traditat humbasin statusin e tyre të lartë si autentike. Vetëm teksti autentik i një tradite, apo hadithi pra, mund të përdoret si një burim për udhëzim, si metodologjik ashtu dhe praktik.

8. Probabiliteti i trillimit në tekstin e hadithit

Nuk ka asnjë kundërshtim ndaj faktit se rreth dy dekada mbas Pejgamberit, kishte tradita që u trilluan dhe që gabimisht iu mveshën atij. Numri i këtyre traditave të shpikura shkon në mijëra sosh. Pa dyshim, dijetarët e hadithit kanë bërë çmos që të identifikonin hadithet e vërteta nga ato të rreme, por, pavarësisht nga kujdesi dhe përpjekja e madhe nga ana e tyre, ata nuk kanë mundur të garantojnë një saktësi në njëqind për qind. Si pasojë, mbetet mundësia që disa tradita të trilluara të konsiderohen sot e kësaj dite si të vërteta thjesht për shkak të zinxhirit autentik të transmetuesve që paraqitet aty. Dijetarët kanë identifikuar tashmë, për shembull, rreth nëntëdhjetë hadithe në *Sunenin e Ibn Maxhes* si të trilluar, apo të shpikur. A do t’ia mbyllim vallë përjetësisht derën ekspozimit të tyre? Sa i përket zinxhirit të transmetimit, ai mund të konsiderohet i mbyllur, por në terma të shqyrtimit teksual dera duhet të qëndrojë e hapur. Me fjalë të tjera, ne nuk kemi asnjë mënyrë që të kontrollojmë për hadithe të shpikura në burimet më popullore përveç shqyrtimit të tekstit të traditave përkatëse.

9. Polemika fikhije në gjirin e fukahave

Polemika të shumta ekzistojnë në gjirin e juristëve muslimanë sa i përket çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me

jetën islame. Njëra prej arsyeve kryesore të këtij fenomeni është se tekste të caktuara të një tradite të veçantë janë të parapëlqyera përballë teksteve të tjera. Në vend se të cilësohen të gjithë si autentikë, mund të ndodhë që disa janë autentikë nga këndi i i zinxhirit të transmetimit, por nuk janë domosdoshmërisht autentikë në terma të tekstit. Polemika *fikhije* mund të kapërcehet kësodore nëpërmjet vërtetimit të tekstit të hadithit.

10. Shenjtëria e hadithit

Ahmed ibn Hanbelin e pyetën njëherë se përse ai hulumtonte jetën dhe karakterin e një transmetuesi dhe duke i shpallur ata më pas ose të besueshëm, ose të dobët, ose gënjeshtarë, sidomos kur kjo mund të cilësohej si një formë e përgojimit të njerëzve, praktikë e paligjshme kjo në Islam. Ai, me një siguri të fortë në vete, thoshte se nuk e vriste fort mendjen nëse njerëzit e prekur prej tij do t'i ankoheshin atij në Ditën e Gjykimit, pasi nuk mund të pranonte që të përballej me një situatë në cilën Pejgmaberi do të ishte paditës kundër vetë atij në Ditën e Gjykimit me ankesën se nuk kishte bërë asgjë për të garantuar autenticitetin e haditheve pejgamberike. Përgjegjësia e dijetarëve akoma nuk ka mbaruar. Ata duhet të vazhdojnë që të bëjnë çmos për të mos lënë asnjë boshllëk apo zbrazëti në autentifikimin e Hadithit. Hadithi ka një pozitë mjaft të shenjtë në jetën islame, por kjo shenjtëri rezervohet ekskluzivisht për thëniet e vërteta të Pejgamberit.

Historia e kësaj pune kërkimore

Si çdo musliman i shqetësuar, unë nuk ndihesha i qetë përballë idesë së një konflikti në dukje që ekzistonte ndërmjet teksteve të ndryshme të traditave pejgamberike të regjistruara si gjoja të vërteta. Mbasia e diskutova me disa

dijetarë këtë çështje të mospajtimit tekstual, unë ndesha në njërin prej dy reagimeve, ose shkurajim nga ndjekja e mëtejshme e debatit mbi hadithin, ose inkurajim që të vazhdoja diskursin. Pavarësisht nga disa diskutime dhe kundërshtime të nxehta, unë vijova të këmbëngulja dhe vazhdova që të shqyrtoja në lidhje me traditat e regjistruara të Buhariu dhe Muslimi, duke lexuar komentare të hadithit rreth këtyre dy veprave, dhe gjithashtu veçanërisht rreth veprave të Neveviut, 'Ajniut dhe Ibn Haxherit. Mua më duket se komentatorët e hadithit nuk kishin përdorur asnjë parim të mirërrënjosur dhe universalisht të përkufizuar të komentarit të hadithit, dhe se ata nuk kishin qenë të balancuar në përjasjen e tyre ndaj hadithit, duke e vendosur fokusin kryesor mbi zinxhirin e transmetuesve, dhe jo mbi tekstin e traditave. Duke qenë se ndihesha disi i pakënaqur me interpretimet e bëra nga dijetarët e mëdhenj, unë i hyra një pune serioze kërkimore mbi autenticitetin e hadithit nga pikëpamja e tekstit. Aplikova në Universitetin Ndërkombëtar Islam në Malajzi, fitova sponsorizimin, dhe në fund prodhova një studim të titulluar "Autentifikimi i hadithit: ripërkufizimi i kritereve", kopje të të cilit iu dërguan disa dijetarëve, përfshirë edhe dijetarë të hadithit dhe ekspertë në të drejtën islame, me kërkesën që ata të jepnin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre përkatëse. Vëzhgimet e përgjithshme ishin inkurajuese dhe më pas unë dorëzoja për botim një pjesë të vogël të punës kërkimore në një revistë shkencore ndërkombëtare mjaft të mirënjohur në Amerikë, ku dhe u botua, mbas së cilës gjë vendosa që ta botoja si libër, përpjekje kjo që kulmoi në këtë vepër. Në mënyrë që ta bëja këtë, unë u detyrova që të përfshija dy kapituj të rinj që fillimisht nuk kanë qenë pjesë e kësaj pune kërkimore.

Përmbajtja e librit

Kapitulli i parë fokusohet mbi shpikjen, apo trillimin, në traditat pejgamberike nga një perspektivë historike, ku gjurmohen faktorë që çuan aty si edhe masat korrigjuese që janë ndërmarrë nga autoritete të shquara muslimane. Kapitulli i dytë identifikon kontributet e dijetarëve nga dy perspektiva, zinxhiri i transmetuesve dhe teksti.

Kapitulli i tretë shqyrton hadithin në dritë të parimeve dhe udhëzimeve kur'anore. Kapitulli i katërt i kushtohet një shqyrtimi tekstual të hadithit duke përdorur tradita fort autentike të Pejgamberit. Kapitulli pesë merret me të kontrolluarit e autenticitetit të tekstit të hadithit nëpërmjet arsyetimit. Kapitulli i gjashtë diskuton kriterin e rrënjësor në histori për të verifikuar dimensionet historike që gjenden në tekstet e hadithit. Kapitulli shtatë gjurmon pranueshmërinë e hadithit në linjë me një tjetër kriter, si për shembull, moderimin, apo rrugën e mesme.

Kapitulli i tetë dhe i fundit bazohet mbi diskutimin dhe riinterpretimin e një kapitulli të veçantë të Buhariut, *Kitab 'ul-Kader* (Kapitulli mbi Paracaktimin). Në kapitujt e tretë, katërt, pestë, gjashtë dhe tetë traditat e përzgjedhura për shqyrtim dhe interpretim janë marrë nga Buhariu dhe Muslimi.

Personalisht, besoj fuqimisht se diskutimet e ndërmarra në këto kapituj janë, në një masë të madhe, origjinale. Unë jam përpjekur që të bëjë dy gjëra në diskutimet e ndërmarra, së pari, të përkufizoj racionalisht kriteret e tekstit të hadithit, dhe së dyti, t'ua zbatojë ato sinqerisht traditave të përzgjedhura duke përdorur metodologjinë relevante.

Në fund, datat e cituara për dijetarë dhe individë të ndryshëm të listuar përmenden vetëm kur ato shfaqen për herë të parë në këtë tekst.

Përkthimi ajteve të Kur'anit

Ajetet kur'anore të cituara përgjatë gjithë kësaj vepre janë marrë kryesisht nga përkthimet e Abdullah Yusuf Ali, Muhammad Asad, dhe Muhammad Muhsin Khan, me një preferencë të përgjithshme që i është dhënë përkthimit të Muhammad Asadit, që unë besoj se bazohet mbi konceptin e unitetit tematik në Kur'an. Sidoqoftë, përkthimi më i përshtatshëm për ajetin (ajetet) në fjalë është përdor kudo ku ka qenë e mundur.³

Rëndësia e Kapitullit të Tetë – Kapitulli i Buhariut mbi Paracaktimin/Parashkrimin

Lexuesve mund t'u duket se kapitulli i tetë nuk është i lidhur me temën e këtij libri dhe se traditat e diskutuara fare lehtë mund të riorganizoheshin në mënyrë më të përshtatshme nën kapitujt tre, katër, pesë, gjashtë dhe shtatë, ku kriteret gjegjëse janë zbatuar për të përcaktuar autenticitetin e traditave pejgamberike. Megjithatë, njëzet e shtatë traditat e *Kitab 'ul-Kader* të Buhariut (kapitulli mbi paracaktimin/parashkrimin) nuk mund të vlerësoheshin lehtësisht vetëm sipas disa kriterëve të veçanta. Ato më tutje kishin nevojë që të trajtoheshin ndarazi, praktikisht për shkak se këto tradita kanë nevojë për analizë nga disa kënde, dhe rrjedhimisht nuk mund të shpërndareshin në kapituj të ndryshëm, dhe psikologjikisht për shkak të natyrës së lëndës së *Kitab 'ul-Kader* dhe impaktit të tij të thellë mbi psikën muslimane.

Një apel i sinqertë

Në akademinë muslimane, specifikisht në atë fetare, ato vepra që duken se ndryshojnë nga normat dhe besimet

³ Në botimin shqip të kësaj vepre, jemi përpjekur t'i qëndrojmë besnikë përkthimit nga anglishtja për shkak të ndjekjes së argumentit të autorit, por si bazë janë përdorë përkthimet e Kur'anit të Sherif Ahmetit, Hasan Nahit dhe Sali Ferhatit, sh.p.

me rrënjë të thella refuzohen menjëherë si të pakuptimta. Dogma e rrënjësor në raport me hadithin përbëhet nga dy përbërës:

1) Në qoftë se zinxhiri i transmetimit është autentik, hadithi konsiderohet autentik pavarësisht nga problemi (problemet) që mund të përmbajë teksti i tij.

2) Traditat, apo thëniet pejgamberike, të përzgjedhura dhe të mbajtura shënim nga Buhariu dhe Muslimi cilësohen si së tepërmi autentike, apo fort autentike. Çdo mospërputhje në dukje në tekstet e këtyre traditave mund të interpretohet, por të deklarojë ndonjë transmetim nga këto dy burime si të pabesueshëm konsiderohet një qëndrim pothuajse i papranueshëm dhe praktikisht një shkelje.

Në këtë studim, unë kam bërë atë çka kam ndjerë sinqerisht se duhet bërë. Objektivi nuk ka qenë kurrësi që të diskreditoja përpjekjen dhe kontributet e pashembullta të dijetarëve të mëdhenj të hadithit, por më saktë që të konsolidoja më tutje pozicionin e hadithit. E megjithatë, unë kurrësi nuk mund të pretendoj përsosmëri në punimin tim, sepse vetëm Allahu është i Përsosur. Përpjekja njerëzore nuk është kurrë e privuar nga mangësitë, dhe në qoftë se ka ndonjë mangësi në prezantimin tim, unë mirëpres që ato të nxirren në pah. Në një botim të mundshëm të këtij libri në të ardhmen, unë do t'i marr në konsideratë këto sugjerime për ndryshime. I lutem Allahut, Burimit të të gjithë dijes, që ta bëjë këtë vepër të përlulur të dobishme për të gjithë ata që kanë interes. Amin!

Israr Ahmad Khan
Korrik 2008

KAPITULLI I PARË

Trillimi në traditat pejgamberike: faktorët shkakësorë dhe masat korrigjuese

Trillimi në traditat pejgamberike, fjalëpërfjalshëm si edhe teknikisht, do të thotë atribuim i rremë i një thënieje apo praktike Pejgamberit *me* apo *pa* qëllim. Transmetimet që përmbajnë të dhëna në lidhje me thëniet apo veprat e Pejgamberit, që ai kurrë nuk i ka thënë apo bërë, refuzohen (*merdud*) në mënyrë unanime si gënjeshtra.

Dijetarët e hadithit kanë identifikuar thënie të ndryshme të përdorura në tradita të cilat tregojnë natyrën e tyre apokrifë, ku disa prej këtyre janë qartësisht tregues të trillimit apo shpikjes, ndërsa të tjerë u referohen trillimit në mënyrë metonimike. Kur autoritetet u referohen disa transmetuesve në një zinxhir të përcjellësve (*sened*) duke përdorur shprehje që janë superlativa, të ekzagjeruara apo thjesht mbiemra të shkallës, për ata këto përbëjnë terma të qartë që sinjalizojnë trillim. Shembuj të formulimeve superlative janë: trilluesi më i madh i të gjithëve (*evda' un-nas*), burimi i gënjeshtres (*menba' 'ul-kedhib*), gënjeshtra mbaron me filanin (*el-kidhbu jentehi ilejhi*), jashtëzakonisht i dhënë pas gënjeshtreve (*kedhdhab*), falsifikator i pandreqshëm (*dexhxhal*), ai që shpik falsitet me fanatizëm (*effak*) etj. Shembuj të mbiemrave të shkallës së thjeshtë janë: Filani trillon hadithe (*fulanun jada'u 'ul-hadith*), filani sajon hadithe (*fulanun jah-telik el-hadith*), njëri apo tjetri autoritet i hadithit e ka shpallur filanin se është gënjeshtar (*fulanun kedhdhebehu*) etj. Disa referenca metonimike ndaj transmetuesve gjithashtu vërtojnë se transmetimet në fjalë janë të rreme pasi filani përcjell transmetime të rreme (*fulanu juhaddithu bi 'l-ebatil*) dhe

në adresë të tij ka transmetime të rreme (*lehu ahadith batileh*). Në mënyrë të ngjashme, autoritetet e hadithit përdorin disa terma për të shpallur një hadith si të papranueshëm. Këtu hyjnë *mevdu'* (të trilluar), *batil* (të rremë) dhe *hadha 'l-hadithu la asle lehu* (ky hadith është i pabazë) etj.

Sfondi historik i trillimit të haditheve

Sipas historianëve, të cilët fokusohen veçanërisht mbi ngjarjet gjatë halifatit të Osmanit r.a.,⁴ ishte fillimisht Ibn Sebe' ai i cili shpiku hadithe në emër të Pejgamberit në një përpjekje për të njollosur imazhin e Islamit dhe për të shkaktuar përçarje në gjirin e muslimanëve.⁵ Kjo do të dukej se lë të kuptohet që trillimi i haditheve pejgamberike filloi në mesin e halifatit të Osmanit.

Sipas gjykimit të Ekrem Dija 'ul-Umrit, personi i parë që trilloi një hadith në emër të Pejgamberit ishte Ibn 'Adisi, njëri prej oponentëve të halifit të tretë, Osman ibn Afanit. Ai raportoi në mënyrë të rreme një thënie të Pejgamberit me autoritetin e Abdullah ibn Mes'udit e cila përmbante një dënim të Osmanit.⁶ Nga kjo krijohet ideja se trillimi në traditat pejgamberike filloi aty nga fundi i halifatit të Osmanit.

Muhammed Ebu Zahw dhe Ahmed Emin, në krahun tjetër, besojnë se trillimi në traditat pejgamberike filloi më herët dhe mund të gjurmohet në kohën e vet Pejgamberit.⁷ Evidenca e tyre e vetme për ta mbështetur këtë pretendim është paralajmërimi i Pejgamberit: "Ai i cili me qëllim më mvësh mua ndonjë gënjeshtër, ai le t'i caktojë vetes një

⁴ Ibn al-Athir, 'Iz al-Din, *Al-Kamil fi al-Tarikh* (Bejrut: Dar Ihya' al-Turath al-'Arabi, 1989), vol. 2, fq. 277–278.

⁵ *Radij'All-llahu anhu* - Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Thuhet sa herë që një Shok i Nderuar, apo Sahab i Pejgamberit Muhamed përmendet me emër.

⁶ Umar ibn Hasan Uthman Fallatah, *Al-Wad' fi al-Hadith* (Damask: Maktabah al- Ghazaly, 1981), vol.1, fq.183.

⁷ Ahmad Amin, *Fajr al-Islam*, botimi i pestë (Kajro: Compilation, Translation, and Publication Committee Press, 1930), fq.258; Abu Zahw, Muhammad, *Al-Hadith wa al-Muhaddithun*, botimi i parë Kajro: 1958), fq. 480.

vend në zjarrin e ferrit.”⁸ Ky arsyetim është paksa i sforcuar pasi Pejgamberi fare lehtë mund ta ketë bërë këtë deklaram si një masë parandaluese për të siguruar origjinalitetin e thënieve dhe veprave të tij (ka pasur asokohe një tendencë në shoqërinë arabe që dikujt t’i atribuoheshin thënie në mënyrë të rreme) dhe jo domosdoshmërisht që të paralajmëronte ata në gjirin e ndjekësve të tij të cilët mund të kishin filluar tashmë të trillonin hadithe në emrin e tij. Krahas kësaj, Shokët e Nderuar të Pejgamberit ishin kaq të sinqertë në përkushtimin e tyre ndaj tij, një besnikëri gati-gati legjendare kjo në natyrë, sa që është e pakonceptueshme që edhe madje të imagjinohet se ata me vetëdije do të trillonin hadithe në emër të tij. Ata e donin atë më shumë se këdo tjetër, përfshirë madje edhe vetet e tyre, dhe kanë qenë të përgatitur që të jepnin madje edhe jetën për të.

Muhamed Ebu Shehbeh e gjurmon trillimin në traditat pejgamberike në vitin 41 të hixhretit kur armiqtë e halifit të tretë ia kishin dalë mbanë që të nxisnin njerëzit kundër tij. Ai cilëson Ibn Seben si iniciatorin e shpikjes së haditheve dhe i atribuimit me pa të drejtë të shumë traditave Pejgamberit. Një hadith i tillë i trilluar thoshte se Pejgamberi e ka shpallur Ali ibn Ebu Talibin pasues të tij [në krye të muslimanëve].⁹ Megjithatë, Ebu Shehbe duket se ka lënë pa vënë re një faktor të rëndësishëm historik, atë se halifi i tretë u ekzekutua në vitin 35 të hixhretit. Pra, në qoftë se Ibn Sebaja ka qenë vërtet i pari që ka filluar aktin e pabesë të të trilluarit të haditheve në emër të Pejgamberit për të nxitur muslimanët kundër fesë së tyre, kundër njëri tjetrit dhe kundër udhëheqësve të tyre, atëherë kjo nuk duhet të ketë ndodhur në vitin 41 të hixhretit, por në vitin 30 h.

⁸ Muslim, ibn al-Hajjaj al-Qushayri, *Sahih* (Bejrut: Dar Ihya’ al-Turath al-‘Arabi, 2000).

⁹ Abu Shahbah, Muhammad, *Al-Isra’iliyyat wa al-Mawdu’at fi al-Tafsir* (Kajro: Majma’ al- Buhuth al-Islamiyyah, 1973), fq.32–34.

Subhi Salihu beson se për herë të parë trillimi u regjistrua si dukuri gjatë fillimit të sundimit të halifit të katërt, Ali ibn Ebi Talibit, që don të thotë, gjatë një kohe kur bashkësia muslimane ishte ndarë në kampe të ndryshme. Çdo bashkësi luajti një rol të sajën në shpikjeve e haditheve që iu atribuan Pejgamberit, dhe kjo për të fituar mbështetje për pozicionin e saj.¹⁰

Përmbledhtazi, do të dukej se trillimi i haditheve pejgamberike filloi dikur rreth mesit të halifatit të Osmanit, pati kulmin gjatë kohës së Aliut dhe Muaviut dhe vijoi në vitet e mëvonshme të historisë muslimane deri në periudhën abasite.

Shkaqet e trillimit

Mund të mos jetë e vështirë që të gjurmohen faktorët kryesore që çuan në trillimin e haditheve Pejgamberike. Madje edhe një shqyrtim i shpejtë i transmetimeve të trilluara prodhon një indikacion të asaj se çfarë u sajua në emër të Pejgamberit dhe pse. Kur vjen puna te trillimet e qëllimshme duket se hadithet u shpikën në emër të Pejgamberit nga ata të cilët:

a) ishin shumë të interesuar që të bindnin popullësinë e përgjithshme për qëndrimet e tyre përkatëse mbi Halifatin dhe se kush do të ishte pasuesi,

b) donin të njollosnin origjinalitetin e mësimave islame,

c) donin të promovonin bizneset e tyre përkatëse,

d) dëshironin të tërhiqnin me një zell të tepruar njerëzit drejt një jete fetare,

e) dëshironin fitime të kësaj bote duke i kënaqur njerëzit që ishin në pushtet dhe,

f) aspironin që të fitonin famë si të ditur.

¹⁰ Subhi al-Salih, *'Ulum al-Hadith wa Mustalahuhu* (Bejrut: Dar al-'Ilm li al-Malayin, 1959), fq.266–267.

1. Lëvizjet politike

Në pjesë të caktuara të perandorisë muslimane që po zgjerohej kishte pakënaqësi ndaj mënyrës se si Osmani, halifi i tretë, kishte trajtuar çështjet administrative të shtetit dhe kjo përfundimisht kulmoi me ekzekutimin e tij, një ngjarje e tmerrshme kjo që tronditi popullësinë e përgjithshme dhe udhëheqësit e shoqërisë. Kur Aliu u caktua si halifi i katërt, një numër personalitetesh udhëheqëse kërkuan masa të rrepta kundër atyre që ishin përgjegjës për zhytjen e bashkësisë muslimane në kaos. Duke qenë se halifi i ri kishte metodën e tij për zgjidhjen e problemit, bashkësia muslimane ra edhe njëherë pre e ndasive dhe e përçarjes, kësaj here në tre kampe kryesore politike, njëri në favor të Muaviut, njëri në favor të Aishes, dhe i fundit në favor të Aliut. Ndasitë politike çuan në konflikte ushtarake të ashpra ndërmjet palëve kundërshtarë. Këto beteja jo vetëm që shkaktuan humbje të rënda në gjirin e palëve ndërluftuese por krijuan gjithashtu edhe një mjedis psikologjik të mbarsur me mosbesim, aq sa shumica e shoqërisë muslimane filloi të tronditej që situata ishte bërë aq e rënduar. Çdo fraksion politik dëshironte të fitonte shumicën e muslimanëve në anën e tij, dhe njëra nga mënyrat më të mira për ta realizuar këtë ishte shpikja e haditheve në emër të Pejgamberit në mbështetje të pozicioneve të tyre përkatëse.

Traditat e trilluara në këtë situatë të acaruar qenë të dy kategorive, njëri grup dënonte udhëheqësit e spikatur dhe tjetri i lavdëronte ata. Për shembull, mund të gjurmohet se si u bë e ngritur pozita e Muaviut duke shqyrtuar hadithet relevante të trilluara sipas kategorisë së dytë. Transmetimi i parë përmend se Kryeengjëlli Xhebrail (Gabriel) zbriti te Pejgamberit me një penë të artë. Pejgamberit më pas iu kërkua që penën, në përputhje me vullnetin e Allahut, t'ia

jepte Muaviut dhe ta këshillonte atë që me të të shkruante Ajetin Kursi (El-Bekare /2:255). Duke përdorur penën, Muavija shkroi ajetin (në një kaligrafi mjaft të bukur) mbas së cilës gjë Pejgamberi e vuri atë në dijeni se Allahu ia kishte shtuar llogarinë e tij me një shpërbllim të akumuluar që është i barabartë me recitimën e atij ajeti nga të gjithë lexuesit e tij deri në Ditën e Gjykimit.¹¹ Transmetimi i dytë citon Pejgamberin në këtë thënë: “Në sytë e Allahut ka tre figura të besueshme, unë, Xhebraili, dhe Muaviu.”¹² Një Transmetim i tretë citon se Pejgamberi ka thënë: “Allahu ia ka lënë amanet shpalljet e Tij Xhebrailit në qiell, dhe Muhamedit dhe Muavi ibn Ebi Sufjanit mbi tokë.”¹³ Në një transmetim të katërt, Pejgamberi thuhet se e ka thërritur Muaviun dhe kur ai erdhi i urdhëroi ata që ishin të pranishëm përreth tij, përfshirë dhe Ebu Bekrin dhe Omerin, që t’ia besonin Muaviut udhëheqjen e muslimanëve për shkak se ai ishte më i fuqishmi dhe më i besuari.¹⁴ Një transmetim i pestë citon Pejgamberin se ka thënë që në Ditën e Ringjalljes, Muaviu do të ringjallet i veshur me një mantel bërë prej drite.¹⁵

Në kontrast të plotë, dënimi i Muaviut është gjithashtu i dukshëm nga transmetimet e trilluara. Në një rrëfim, Pejgamberi thuhet se ka përmendur: “Në qoftë se ju e shihni Muaviun në këtë minber të veçantë, vriteni atë.”¹⁶ Në një transmetim të dytë, Pejgamberi e vë në dijeni Muaviun se ai, “si udhëheqës i muslimanëve, do ta bënte të ligën të mirë, dhe të mirën të ligë; dhe se zullumet e tij do të jenë të pasosura.”¹⁷

¹¹ Ibn al-Jawzi, ‘Abd al-Rahman ibn ‘Ali, “*Kitab al-Mawdu‘at*” (Bejrut: Dar al-Kutub al-‘Ilmiyyah, 1995), vol.1, fq.328–329.

¹² *Ibid.*, fq.330.

¹³ *Ibid.*, fq.331.

¹⁴ *Ibid.*

¹⁵ *Ibid.*, fq.334.

¹⁶ *Ibid.*, fq.335.

¹⁷ *Ibid.*, fq.338.

Në një transmetim të tretë, Pejgamberi lutet edhe një herë kundër Muaviut dhe Amr ibn Asit duke thënë: “O Allah! Vendosi ata të dy në kaos të rëndë; O Allah! Flaki të dy ata në zjarr.”¹⁸

Hadithe janë trilluar si në favor ashtu dhe kundër Aishes. Në lavdërim të saj ne kemi sa vijon: Engjëlli Xhebrail një herë e vuri në dijeni Pejgamberin se ishte vullneti i Allahut që ai të martohej me njëren prej vajzave të Ebu Bekrit, si pasojë e së cilës gjë Pejgamberi i kërkoi Ebu Bekrit dorën e vajzës së tij në martesë. Ebu Bekri kishte tri vajza për martesë dhe ia tregoi ato Pejgamberit i cili zgjodhi Aishen për shkak se Allahu e kishte nxitur atë që të martohej me të.¹⁹ Kjo është një gënjeshtër mjaft e qartë, dhe kjo e bazuar mbi dy argumente. Së pari, Pejgamberi u martua me Aishen në Mekë, dhe jo në Medine sikurse përcjell kjo traditë. Historikisht, Pejgamberi u martua me Aishen në Mekë, me konsumimin e martesës që ndodhi në Medine. Së dyti, Ebu Bekri kishte vetëm dy vajza në atë kohë, Esmanë dhe Aishen, dhe jo tri sikundërse thotë transmetimi. Në fakt, Ebu Bekri pati një vajzë të tretë, por ajo lindi vetëm mbas vdekjes së tij në vitin 13 të Hixhretit. Ajo quhej Um Kulthum.²⁰

Në terma të dënimit të Aishes, hadithi i mëposhtëm është trilluar për rastin e betejës së Devesë: “Pejgamberi tha se njerëzit që udhëhiqen nga një grua nuk mund të kenë sukses.”²¹

Një numër i madh i traditave që i janë atribuar Pejgamberit janë shfaqur gjithashtu në lëvdim të Ali ibn Ebu Talibit. Disa prej tyre janë të renditura sa më poshtë:

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Ibid., fq.323.

²⁰ Ibn al-Atthir, vol.2, fq.76.

²¹ Ibn al-Jawzi, “*Kitab al-Mawdu’at*,” vol.1, fq.325.

- 1) Pejgamberi tha se ai vetë, Harun ibn Imrani, Jahja ibn Zekerija dhe Ali ibn Ebi Talibi janë krijuar nga po e njëjta baltë.²²
- 2) Pejgamberi ka thënë se Ali ibn Ebi Talibi ishte vëllai i tij, shërbestari i tij dhe pasuesi i tij, i cili do të shlyente borxhet e tij [të Pejgamberit] dhe do të përmbushte premtimet e tij mbas ikjes së tij.²³
- 3) Pejgamberi ka thënë se të parit e fytyrës së Aliut është një akt devotshmërie (ibadet).²⁴
- 4) Pejgamberi ka thënë se ai i cili dëshiron të shohë Ademin me dijen e tij, Nuhun me të kuptuarit e tij, Ibrahimin me urtësinë e Tij, Jahjan me devotshmërinë e tij dhe Musain me sundimin e tij, duhet të shohë Ali ibn Ebi Talibin.²⁵
- 5) Pejgamberi ka thënë se emri i tij në Kur'an ishte *Ve 'sh-Shemsi ve Duhaha* (Pasha diellin dhe shkëlqimin e tij), emri i Ali ibn Ebu Talibit *Ve 'l-Kameru idha telaha* (Pasha hënën teksa ajo e ndjek atë), emri i Hasanit dhe Hysenit *Ve 'n-Nehari idha xhel-laha* (Pasha ditën teksa ajo tregon lavdinë) dhe emri i dinastisë emevite *Ve 'l-Lejli idha jagshaha* (Pasha natën teksa ajo e mbulon atë).²⁶
- 6) Kur Ebu Bekri dhe Omeri i propozuan Fatimes për martesë, Pejgamberi tha: "O Ali! Ajo është për ty, jo për mashtruesit (*dexhalët*)."²⁷

Në kundërdallim, kundër Aliut ne kemi Pejgamberin që i thotë atij: "Udhëheqja nuk është për ty, dhe për ndonjërin prej pasardhësve të tu."²⁸ Duket se ata që ishin armiqësor ndaj Aliut e trilluan këtë hadith në mënyrë që t'i pengonin

²² Ibid., fq.254.

²³ Ibid., fq.259.

²⁴ Ibid., fq.268–271.

²⁵ Ibid., fq.277.

²⁶ Ibid., fq.278.

²⁷ Ibid., fq.286.

²⁸ Ibid., vol. 2, fq. 290.

njerëzit nga të besuarit në të drejtën e Aliut për t'u zgjedhur në krye të halifatit.

Në vitin 66 hixhri, Muhtar Thekafiu, një njeri pa parime dhe intrigant, ngriti krye kundër establishmentit dhe mori pushtetin në Kufë. Ai një herë i kërkoi njërit prej autoriteteve të asokohe të hadithit që të trillonte tradita në emër të Pejgamberit që mund të vleftësonin pozicionin e tij. Në shkëmbim ai i ofroi dijetarit dhjetëra mijëra derhemë, kuaj, një shpurë me sklevër dhe petka të çmuara. *Muhadithi* refuzoi që të vepronte kështu, por në vend të kësaj ra dakord që të trillonte tradita që i atribuoheshin një pjesë të sahabëve, apo Shokëve të Nderuar.²⁹ Në fakt, shumë tradita u trilluan prej motivimit politik si një përpjekje për të diskredituar ata që ishin në pushtet duke i nxjerrë ata si të dënuar nga Pejgamberi. Për shembull, Pejgamberi thuhet se e ka shpallur Jezid ibn Muaviun si vrasësin e Huseinit dhe se e ka mallkuar atë. Në mënyrë të ngjashme, Velid ibn Abdulmeliku u ndëshkua nëpërmjet një tradite të tillë të trilluar në emrin e Pejgamberit.³⁰

2. Misionet armiqësore ndaj Islamit dhe muslimanëve

Në historinë islame hadithe të shumta janë trilluar nga një grup i njohur si *zenadikah* (zindikë, heretikë/hipokritë të cilët së jashtmi shtreshin si pjesë e Islamit, por së brendshmi ushqenin armiqësi, duke përhapur besime heretike). Ata trillonin tradita në pothuajse të gjitha çështjet e jetës islame. Abdulkerim ibn Ebu Arxha ishte njëri prej këtyre heretikëve, i cili do të fuste hadithet e trilluara nga vetë ai në dokumentin e haditheve të vërteta të përmbledhura nga njëri prej të afërmve të tij, Hamad ibn Seleme. Përpara se të ndëshkohej me vdekje, ai pretendoi se kishte shpikur katër

²⁹ Ibid., vol. 1, fq. 17.

³⁰ Ibid., fq. 352–353.

mijë hadithe në emër të Pejgamberit në një përpjekje për ta bërë të ligjshmen të paligjshme dhe të paligjshmen të ligjshme.³¹ Mehdiu, një dijetar i madh i hadithit, transmetohet se ka thënë që njëri prej heretikëve rrëfeu para tij se kishte trilluar katër mijë tradita dhe se i kishte qarkulluar ato në mesin e popullësisë.³²

Krahas kësaj, qyteti i Medinës kishte një numër fisesh judaike format e ndryshme të pabesisë të të cilave kundër Pejgamberit shkaktuan dëbimin e tyre eventual. Me ekspeditat ushtarake dhe propagandën e hapur që nuk ishin opsione të mundura, duket se fraksionet më të mëritura në gjirin e tyre vendosën që të fokusoheshin mbi sabotimin e mësimëve themeltare të Islamit nëpërmjet shpikjes së haditheve. Synimi ishte që të krijohej një krisje në unitetin e muslimanëve dhe një version i ri i fesë. Një rast për t'u vënë në dukje është ai i Ibn Sebes. Një hebre, i cili në dukje përqafoi Islamin, udhëtoi gjerësisht në mbarë shtetin islam me petkun e besimit të tij të ri, duke ia dalë që të mashtronte besimtarë në territoret e reja muslimane. Ai trilloi një numër traditash në emrin e Pejgamberit dhe i qarkulloi ato në mesin e shoqërisë muslimane. Një tjetër rast është ai i Bejan ibn Sem'an Nehdiut, një heretik ky i cili pretendonte se ishte i dërguar i Zotit. Natyrisht, ai duhet të ketë sajuar ndonjë përligjje nëpërmjet haditheve të trilluara prej vetë atij në mbështetje të pretendimit të tij skandaloz. Ai më vonë u ndëshkua me vdekje për blasfemi. Mugire ibn Saidi, një magjisttar, gjithashtu luajti një rol në ndotjen e trashëgimisë së shenjtë të traditave pejgamberike. Atij iu pre koka për këtë shkelje të rëndë.³³

³¹ Ibid., fq.15.

³² Ibid.

³³ Ibid.

Disa shembuj spektakolarë të traditave të trilluara, të fabrikuara nga oponentët e Islamit, jepen sa më poshtë:

- 1) Në përgjigje të një pyetjeje sa i përket elementit bazë të Zotit, Pejgamberi tha se nuk është as nga qielli as nga toka; më saktë, Ai krijoi një kalë dhe e bëri atë që të vraponte; kur kali djersiti, Zoti krijoi Vetën e Tij nga ajo djersë. Kjo traditë u shpik nga një heretik, Muhamed ibn Shuxha' Balhi.³⁴
- 2) Një xhineshë (xhini femër) vizitonte Pejgamberin bashkë me xhinesha të tjera. Një ditë ajo erdhi vonë. Kur Pejgamberi e pyeti përse, ai tha: "Vajta në Indi për t'i shpehur ngushëllimet një familjeje në zi. Rrugës pashë diçka mjaft të çuditshme." Pejgamberi më pas e pyeti që të tregonte se çfarë kishte parë. Ajo vazhdoi më tutje: "Pashë Shejtanin duke falur namaz mbi një shkëmb. Kur e pyeta se çfarë e shtyti atë që të kequdhëzonte pasardhësit e Ademit, ai i bëri bisht pyetjes. Kur e pyeta përse, ai më pas u fal dhe u përgjigj se ai shpresonte që të fitonte faljen e Zotit të tij." Mbas kësaj, Pejgamberi qeshi në një mënyrë të atillë që nuk qeshi kurrë më së-
rish.³⁵ Sipas të gjitha gjasave, ky trillim kishte për qëllim që të krijonte njëfarë simpatie për Shejtanin në zemrat e muslimanëve.
- 3) Pejgamberi a.s. tha: "Ai nga duart e të cilit një jobesimtar pranon Islamin do të trashëgojë pronë nga muslimani i ri."³⁶ Kjo është qartazi një përpjekje për të ndryshuar ligjin e trashëgimisë në Islam.
- 4) Pejgamberi a.s. tha: "Ai që nuk e ka dhënë zekatin gjatë jetës së tij, mund ta kompensojë këtë humbje duke e lënë trashëgiminë e tij në dritën e Kur'anit."³⁷ Ky trillim

³⁴ Ibid., fq.64.

³⁵ Ibid., fq.146.

³⁶ Ibid., fq.404.

³⁷ Ibid., fq.396.

qartazi ka pasur për qëllim që të ngushëllonte ata që kishin shmangur dhënien e zekatit.

- 5) Pejgamberi a.s. tha: “Në vitin 150, përmbahuni nga martesja; atij që martohet në atë vit, Allahu do t’ia marrë mendtë dhe do t’ia shkatërrojë fenë, dhe ai do të jetë i privuar si në këtë botë ashtu dhe në amshim.”³⁸ Duket se këta trillues dëshironin që të dobësonin muslimanët nga pikëpamja demografike duke i shkurajuar ata nga martesja.
- 6) Pejgamberi a.s. tha: “Nuk ka gjë që e cenon fenë negativisht, sikundërse nuk ka gjë që të sjellë diçka të mirë me politeizmin.”³⁹ Ky hadith është trilluar në mënyrë që të nxiste muslimanët që të bënin si të dëshironin, qoftë për mirë apo për keqe, dhe t’i bindte ata se mund të kryenin gjynahe si vjedhja, gënjeshtria, tradhëtia bashkëshortore dhe kurvëria, vrasja e dikujt pa të drejtë, marrja e fajdes, uzurpimi i pronës së tjetrit e tjera ... pa pasur kjo ndonjë ndikim të pafavorshëm mbi besimin e tyre.
- 7) Pejgamberi a.s. tha: “Nuk ka për të pasur pejgamber pas meje - por jo në qoftë se Allahu dëshiron të kundërtën.”⁴⁰ Pjesa e parë e kësaj tradite – “Nuk ka për të pasur pejgamber pas meje” – është një thënie e vërtetë e Pejgamberit, e regjistruar në veprat më autentike të hadithit, përfshirë Sahihun e Buhariut dhe Sahihun e Muslimit. Pjesa e dytë e thënies – “por jo në qoftë se Allahu dëshiron të kundërtën” – është një futje e vonë nga një heretik i mirënjohur, Muhamed ibn Saidi. Këta armiq të Islamit ishin më se të vetëdijshëm se baza unike e fesë ngrihej mbi faktin se Pejgamberi Muhamed ishte i mbraimi i pejgamberëve. Synimi i qartë i trillimeve të tilla si këto ishte për rrjedhojë që të krijonte dyshime në men-

³⁸ Ibid., fq.375.

³⁹ Ibid., fq.90.

⁴⁰ Ibid., fq.206.

djet e njerëzve sa i përket të qenit i fundit i Pejgamberit Muhamed dhe më tutje të largohej dyshimi në lidhje me pozitën e mashtruesit mbas tij. Krahas kësaj, Muhamed ibn Saidi ka pretenduar se sa herë që ai dëgjonte një thënie që në pamje të parë atij i dukej e këndshme, ai zhvillonte për të një zinxhir të transmetuesve që e lidhte atë me Pejgamberin!⁴¹

3. Konfirmimi i shkollave të veçanta të mendimit

Zgjerimi i territorit islam dhe shtrirja e kufijve të tij deri në Romë dhe Persi solli në jetë një ndërveprim midis muslimanve dhe njerëzve të zotërimeve të reja. Trashëgimia e këtyre të fundit kaloi në duart e muslimanëve dhe kjo dije e re e huazuar dhe e mësuar nga të tjerët çoi në shfaqjen e debatit në gjirin e dijetarëve, që përfundimisht rezultoi në lindjen e disa mendimeve dhe pikëpamjeve kontradiktore, sidomos të një natyre filozofike. Temat kryesore të këtyre debateve kishin të bënin me pozitën e Kur'anit, konceptin e parapërgatitjes së kismetit/destinit të njeriut, lirisë së njeriut, natyrës dhe pasojës së gjynahëve të mëdha etj. Duke qenë se nuk ishte e lehtë për askënd që të bindte publikun nëpërmjet forcës së thjeshtë të argumentit racional, debatuesit dhe përkrasit e një pikëpamjeje të veçantë shfrytëzuan edhe trillimin e traditave në emër të Pejgamberit.

Entuziastët e grupeve teologjike historikisht të mirënjohura, mu'tezilitë, murxhitë, kaderitë, xhebritë dhe esh'aritë⁴², kuturisën në territor të ndaluar dhe guxuan që të trillojnë hadithe në emër të Pejgamberit si për të quajtur të vlefshme shkollat e tyre gjegjëse të mendimit. Një pjesëtar i

⁴¹ Ibid., fq.207.

⁴² Imam Esh'ariu dhe nxënësit kryesorë të shkollës nuk janë nga ata që kanë trilluar hadithe, ndaj redaksia e konsideron mendim individual të autorit këtë konstatim. Esh'arizmi në akaid dhe shafi'izmi në fikh konsiderohen, krahas hanefizëm-maturidizmit, shtyllë të ehli-sunetit dhe xhematit. (Redaksia).

penduar i njërës prej këtyre shkollave ka zbuluar se çfarë kanë bërë ai dhe të tjerë si ai nga i njëjti kamp dhe ka thënë: “Sa herë që ne shihnim një opinion që ishte për t’u çmuar, ne e shndërronim atë në një traditë pejgamberike.”⁴³

Për shembull, njëra prej shkollave të mendimit besonte se besimi (*iman*) nuk ishte statik, por më saktë shtohet dhe pakësohet. Megjithatë, përkrahësit e kësaj ideje ishin të pakënaqur me linjën e tyre të të arsyetuarit dhe filluan që t’ia atribuonin këtë thënie Pejgamberit si për të përforcuar më tutje qasjen e tyre dhe të bindnin njerëzit në përgjithësi për vërtetësinë e saj. Një tjetër grup që favorizonte idenë e kundërt, se besimi ishte në fakt statik, sipas leverdisë së tyre nxorën një traditë të kundërt në mbështetje të besimit të tyre, duke trilluar thënien e mëposhtme në emër të Pejgamberit: “Një delegacion nga Thakifi e pyeti Pejgamberin nëse besimi shtohet apo pakësohet. Pejgamberi iu përgjigj: “Besimi është i ngulitur në zemra si malet e ngritur vendosmërisht mbi tokë; shtimi dhe pakësimi i tij përbën blasfemi.” Grupi murxhitë sajoi shumë tradita të tjera në të Pejgamberit për të vërtetuar autenticitetin e pikëpamjes së tyre. Muhamed ibn Kasim Talkaniu, një udhëheqës i spikatur i këtij grupi, është një rast i tillë për t’u përmendur. Ai trilloi shumë tradita për të provuar pikëpamjen e grupit, përfshirë dhe sa më poshtë:

Pejgamberi a.s. tha: “Ata të cilët kanë shpallur shtimin dhe pakësimin në besim duhet të dinë se shtimi i tij është hipokrizi dhe pakësimi i tij është blasfemi. Në qoftë se ata pendohen, lërini ata; në mos, bjeruni në qafë me shpatë. Ata janë armiqtë e Më të Mëshirshmit. Mos harroni, namazi, agjërimi, zekati, haxhi dhe feja e tyre nuk janë të pranuar. Ata nuk kanë lidhje me Pejgamberin.”⁴⁴

⁴³ Ibid., fq.16.

⁴⁴ Ibid., fq.84–87.

Xheberitët besonin në destinin/kismetin e parashkruar të njeriut. Për të rrëzuar këtë pikëpmaje, Kaderitët trilluan një traditë në emrin e Pejgamberit sikurse vijon: “Në ditën e Gjykimit, Allahu do t’i grumbullojë të gjithë në të njëjtin vend; një zë nga poshtë fronit hyjnor do të thërrasë: “Vëreni! Dikush që ka dëlirësuar gjynahet e tij, lëreni të hyni në Parajsë!”⁴⁵

Fanatikët e këtyre shkollave teologjike kapërcyen të gjitha caqet, duke trilluar hadithe në emër të Pejgamberit për të dënuar njëri tjetrin, dhe me sa dukej ata e kishin harruar krejtësisht seriozitetin e asaj çfarë ata po vepronin. Shembuj të mëtejshëm të traditave të tilla të trilluara jepen sa më poshtë:

- 1) Pejgamberi a.s. tha: “Me të vërtetë, për çdo komunitet ka një magjian [prift zoroastrian sh.p.]; magjianët e këtij umeti janë kaderitët. Mos i vizitoni ata kur i kaplon sëmundja; dhe mos iu bashkoni namazit të xhenazes së tyre mbasi ata vdesin.”⁴⁶
- 2) Një herë Pejgamberi a.s. tha se Allahu kishte mallkuar katër kategori njerëzish nëpërmjet gjuhëve të shtatëdhjetë pejgamberëve. Shokët e tij të Nderuar më pas pyetën për identitetin e tyre. Pejgamberi iu përgjigj: “Kaderitët, xhehmitët, murxhitët dhe rafiditët.” Kur atij iu kërkua që të shpjegonte problemet e tyre, Pejgamberi tha: “Kaderitët pretendojnë se e mira është nga Allahu dhe e keqja nga Shejtani: Mos harroni! E mira dhe e keqja vijnë të dyja nga Allahu – cilido që thotë diçka tjetër përpos kësaj, ai është i mallkuar; Xhehmitët thonë se Kur’ani është krijim: Mos harroni! Kur’ani është jo-krijim, cilido që thotë diçka tjetër përpos kësaj, ai është i mallkuar; Murxhitët besojnë se besimi është thjesht shqiptim pa veprim; Rafi-

⁴⁵ Ibid., fq.200.

⁴⁶ Ibid., fq.202.

ditë fyejnë Ebu Bekrin dhe Omerin. Mos harroni! Ai që ka zemëruar këta të dy, ai është i mallkuar.”⁴⁷

- 3) Pejgamberi a.s. tha se në qoftë se trupi i vdekur i një kaderiti apo murxhiti do të nxirrej nga dheu tri ditë mbas varrosjes, fytyra e tij do të ishte e kthyer kah një drejtim të ndryshëm nga ai e Qabesë.⁴⁸
- 4) Pejgamberi a.s. tha se murxhitët, kaderitët, rafiditët dhe harixhitët do të zhvishen nga besimi i tyre në unitetin e Zotit me një të katërtën dhe do të hidhen në zjarr si jobesimtarë ku do të rrojnë përjetësisht.⁴⁹

Është jashtëzakonisht e habitshme që besnikët e shkollave teologjike të mendimit kanë shkuar deri aty duke keqpërdorur emrin e Pejgamberit thjesht për t'i dhënë legjitimitet opinionit të tyre dhe për ta përkrahur atë.

4. Rivaliteti në jurisprudencë

E drejta islame është interpretuar nga juristë të shumtë. Më të shquarit ndër ta janë Ebu Hanifja (vd. 150 h.), Malik ibn Enesi (vd. 179 h.), Muhamed ibn Idris Shafiu (vd. 204 h.) dhe Ahmed ibn Hanbeli (vd. 241 h). Ndonëse dallimet në opinion ekzistonin në mesin e tyre mbi shumë çështje, këta dijetarë të mëdhenj i udhëzuan njerëzit duke bërë të pamundur me aftësitë e tyre për të interpretuar të drejtën islame bazuar mbi ixhtihadin e tyre. Fatkeqësisht, ndonëse këto dallime ishin minore në natyrë, ndjekësit e këtyre dijetarëve dhe imamëve të mëdhenj i konsideruan ato si madhore dhe eventualisht filluan të besonin se pikëpamja e imamit të tyre të veçantë ishte e drejta dhe se ajo e të tjerëve ishte e gabuara. Prandaj, ata iu kundërvunë njëri tjetrit. Deri në këtë përmasë, polemika mbeti e tolerueshme, por kur këta ithtarë filluan

⁴⁷ Ibid., fq.203.

⁴⁸ Ibid., fq.204.

⁴⁹ Ibid., fq.205.

të trillonin hadithe në emër të Pejgamberit jo vetëm për të mbështetur shkollat e tyre përkatëse të jurisprudencës, por gjithashtu edhe për të dënuar juristët e shquar më me emër, ata tejkaloan një limit për seriozitetin e të cilit ata duhet të kishin qenë thellësisht të vetëdijshëm. Shembuj të traditave të tilla të shpikura për të mbështetur një pikëpamje të veçantë mbi një çështje të caktuar citohen më poshtë:

- 1) Pejgamberi a.s. tha se atij që ngre duart e tij në namaz nuk do t'i pranohet namazi.⁵⁰ Ky hadith është trilluar për të rrëzuar atë që ishte transmetuar në tradita autentike që thonë se Pejgamberi dhe Shokët e tij të Nderuar i ngrenin duart në namaz. Ky është një shembull befasues i paragjykimit nga ana e ithtarëve të juristëve. Çuditërisht, ata tregojnë fare pak kujdes ose nuk tregojnë aspak për shenjtërinë e veprave dhe thënieve të vërteta të vetë Pejgamberit mbi çështjen në fjalë, gjë që do të thotë se ata i kanë dhënë një vlerë më të madhe mbizotërimit të shkollës së tyre përkatëse të jurisprudencës. Me fjalë të tjera, atyre nuk u interesonte nëse qasja e tyre e verbër hidhte dyshime mbi autenticitetin e haditheve të vërteta të Pejgamberit.
- 2) Engjëlli Xhibril e vuri në dijeni Pejgamberin se Allahu e urdhëroi atë që falte namazin sipas mënyrës së Xhibrilit dhe engjëjve të tjerë në qiellin e shtatë: domethënë, “ngrejini duart në fillimin e namazit dhe thoni *Allahu Ekber*, dhe bëni të njëjtën gjë kur të përkulen, apo bini në ruku, dhe gjithashtu kur të ngrini kryet nga sexhdeja, apo të qenit të gjunjëzuar. Me të vërtetë, për çdo gjë ka një shkallë; shkalla e namazit është ngritja e duarve në çdo shqiptim të *Allahu Ekber*.”⁵¹ Përkrahësit e ngritjes së duarve nuk e konsideruan të mjaftueshme praktikën e Pejga-

⁵⁰ Ibid., vol.2, fq.22.

⁵¹ Ibid., fq.23.

mberit dhe të Shokëve të tij në këtë drejtim dhe trilluan një hadith që përkrahte pikëpamjen e tyre me forcë.

Të pafytyrët gjithashtu trilluan një hadith që dënonte juristin e madh Shafiun ndërkohë që shprehte admirim për Ebu Hanifen: “Ka për të pasur një njeri që do të quhet Muhamed ibn Idris Shafiu në umetin tim; ai do të jetë më i dëmshëm për umetin tim se sa Shejtani; dhe gjithashtu ka për të pasur një njeri tjetër në umetin tim që do të quhet Ebu Hanife; ai ka për të qenë fanari i umetit tim, ai ka për të qenë fanari i umetit tim.”⁵²

5. Propaganda komerciale

Njeriu është një qenie materiale dhe ka nevojë që të ketë qasje në burimet e jetës. Njëra prej mënyrave për t’i përfutur këto është që thjesht t’i blejë ato nga dikush tjetër, dhe për këtë ekziston nevoja e një akti të shitjes. Që nga kohë që s’mbahen mend, njeriu ka ushtruar artin e tregtisë, duke blerë e shitur të mira për të plotësuar nevojat e tregut. Të gjitha bizneset, qofshin të mëdha apo të vogla, kanë nevojë për njëfarë forme të publicitetit për të promovuar shitjet dhe ndërkohë që në kohët moderne kjo merr formën e reklamave tej mase tërheqëse dhe vizualisht trullosëse si në median elektronike ashtu dhe atë të shkruar, në kohët e vjetra ky sistem nuk ishte akoma i disponueshëm. Gjatë shekullit të parë, të dytë dhe të tretë mbas hixhretit, kur sundimi islam ishte përhapur në pjesën më të madhe të botës, dyqanxhinjtë dhe tregtarët duhet të reklamnin mallrat e tyre dhe e vetmja mënyrë në dispozicion për publicitet tregtar ishte komunikimi verbal. Duket se biznesmenët shfrytëzuan edhe përdorimin e haditheve pejgamberike për këtë qëllim. Fatkeqësisht, kur ata dështonin që të gjenin diçka në literaturën e hadithit për të promovuar mallrat e

⁵² Ibid., vol.1, fq.354.

tyre, ata guxonin që të shpiknin hadithe në emër të Pejgamberit për t'i bërë bizneset e tyre me fitim dhe për të tërhequr gjithnjë e më tepër klientë. Në burime del qartë se u trilluan një numër traditash që lavdëronin shegët, hurmat e Arabisë, bajamet, pjeprin, rrushin, bukën, qumështin, perimet, trangullin, thjerrëzat, kripën, bulmetrat, radhiqet, mishin e pulës, patëllxhanin, rrobat prej leshi e tjera. Ka mjaft të ngjarë që tregtarët të kenë paguar ata që ishin të zotë që të trillonin tradita në favor të mallrave të tyre përkatëse. Madje kësaj pune i shkuan nga pas edhe mjekët, duke trilluar hadithe që promovonin shitjet e medikamenteve të tyre. Më poshtë ka disa shembuj ilustrues:

- 1) Çdo kokërr shege është e injektuar me një farë të shegës paradiziake.
- 2) Shalqiri është mëshirë dhe ëmbëlsia e tij është si ajo e pjeprit në parajsë.
- 3) Rrushi ka gjëra për të ngrënë dhe për të pirë dhe për të bërë stafidhe prej tij.
- 4) O Allah! Bëj që ne ta shijojmë Islamit dhe bukën; po të mos ishte buka, nuk do të mund të faleshim, të agjëronim, të kryenim haxhin dhe të merrnim pjesë në luftë.
- 5) O Ali! Duhet ta përdorësh kripën sepse ajo shërben si një melhem për shtatëdhjetë sëmundje, si lebra, njollat e bardha dhe çmenduria.
- 6) Pasi provoi gjizën, Pejgamberi shqiptoi këto fjalë: "O Allah! Jepna begati në të dhe shtona begatinë e saj."
- 7) Ai që ha kastravec me mish është i mbrojtur nga lebra.
- 8) Përdorini thjerrëzat sepse ato zbusin zemrën, shtojnë lotët dhe shtatëdhjetë pejgamberë i kanë bekuar ato.
- 9) Bajamja dhe djathi janë të dyja ligështi, por kur shkojnë në stomak, ato bëhen burim shërimi.
- 10) Servirini perimet në sofër sepse ato zbojnë Shejtanin.
- 11) Në çdo gjethe radhiqe ka një pikël nga uji i Parajsës.

- 12) Patëllxhani është një ilaç për çdo sëmundje dhe nuk ka dëm në të.
- 13) Në qoftë se njerëzit do ta dinin peshën e bulmetërave, ata do t'i blinin ato madje edhe duke i shkëmbyer me peshën e arit.
- 14) Pejgamberi i urdhëroi të pasurit që ta hanin mishin e dhisë e të deles dhe të varfërit [i urdhëroi] që të hanin mishin e pulës.
- 15) Një burrë erdhi një ditë te Pejgamberi dhe u ankua për një problem që kishte të bënte me aftësinë e tij seksuale. Pejgamberi, më pas, e këshilloi atë që të hante vezë dhe qepë.
- 16) Jepuni për të ngrënë grave tuaja hurma arabie gjatë periudhës menstruacioneve; kjo do të bëjë që foshnja i lindur më pas të jetë zemërmirë; Merjemja hëngri hurma arabia kur lindi Isai/Jezusi; sikur Allahu të dinte për ndonjë ushqim tjetër më të mirë se sa hurma arabisë, Ai do t'ia kishte sjellë atë asaj.⁵³
- 17) Duhet të vishni petka prej leshi; kjo do t'ju japë ëmbëlsinë e besimit në zemër. Duhet të vishni petka leshi; kjo do t'ju ndihmojë që të ndiheni më pak të uritur. Duhet të përdorni petka leshi; do të kuptoni rëndësinë e tyre në amëshim. Rroba e leshit e shtyn zemrën që të mendojë, dhe të menduarit çon në urtësi, dhe urtësia rrjedh në stomak sikurse gjaku në vena.⁵⁴
- 18) Ai që bën një unazë prej gurit të akikut, apo karnelian, dhe ka gdhendur mbi të – “Kjo është vetëm prej mëshirës së Allahut” – Allahu do t'i japë atij të gjitha të mirat dhe dy engjëjt të cilët janë gjithnjë me të do ta duan atë.⁵⁵

⁵³ Ibid., vol.2, fq.189–227.

⁵⁴ Ibid., fq.245.

⁵⁵ Ibid., fq.252.

- 19) Allahu do ta mbajë varfërinë larg atij që e ka bërë gurin e unazës së tij prej rubini.⁵⁶
- 20) Stomaku është ena e trupit dhe të gjitha venat janë të lidhura me të. Nëse stomaku është i shëndetshëm, venat do të jenë të shëndetshme; nëse stomaku sëmuret, edhe venat gjithashtu do të sëmuren.⁵⁷ Kjo traditë u trillua nga një mjek që quhej Ibrahim ibn Xhurejxh. Me sa duket, ai e bëri këtë gjë për të promovuar klinikën e tij dhe shërbimet e tij si mjek.⁵⁸

Të gjitha këto hadithe janë shpikur në emrin e Pejgamberit a.s. me synimin për të promovuar biznese dhe për të tërhequr gjithnjë e më tepër klientë.

6. Ambicia për të siguruar jetesën dhe për të fituar famë

Ka njerëz që parapëlqejnë ta sigurojnë jetesën në mënyrën më të lehtë të mundshme duke përdorur inteligjencën dhe kreativitetin e tyre, ndërkohë që në të njëjtën kohë orvaten për të sendërtuar një reputacion të mirë veten në gjirin e popullësisë së përgjithshme se janë deri diku “të ditur” (kjo sepse dijetarët çmohen tej mase). Ata përgjithësisht janë qenësisht dembelë, nuk kanë interes që punojnë shumë për të fituar një pagë të respektueshme që të përmbushin nevojat e tyre apo të familjeve të tyre. Gjatë kulmit të qytetërimit islam, njerëz me këtë natyrë do të hynin nëpër xhami dhe do të ftonin të tjerët që t’i dëgjonin ata, duke treguar rrëfenja të së shkuarës, përfshirë edhe legjenda e tjera. Në mënyrë që ta bënë publikun e tyre që të mrekullohej nga oratoria e tyre, ata do të rrëfenin hadithe që i trillonin vetë dhe që ishin të lidhura me Pejgamberin, pasi duke bërë kështu ata kishin me të vërtetë sukses që të fitonin si para ashtu

⁵⁶ Ibid., fq.254.

⁵⁷ Ibid., fq.188.

⁵⁸ Ibid.

dhe famë. xhamia ka qenë dhe është edhe sot një vend publik në shoqërinë islame, dhe aq më tepër gjatë periudhave emevite dhe abasite kur xhamitë kishin një peshë shumë më të madhe. Rrëfenjtarët arrinin të mblidhnin me lehtësi një publik që ishte i gatshëm t'i dëgjonte ata dhe ishte natyral e mrekullishme e rrëfenjave dhe traditave që rroknin vëmendjen e njerëzisë dhe ata bëheshin kësodore një shënjestër e lehtë. Islami mëson butësinë karshi nevojtarëve, kështu që kur rrëfenjtarët hipnotizonin audiencat me magjinë e gojëtarisë së tyre, njerëzit do të dhuronin plot bujari. Pak a shumë si sot, njerëzit në qytetërimin islam zhvilluan një dashuri për ditë dhe vepra të caktuara; në qoftë se ata ndeshnin tradita pejgamberike që pasqyronin dëshirat dhe qejfet e tyre, ata gëzoheshin, dhe rrëfenjtarët, që ishin si mos më mirë të vetëdijshëm për këtë psikë njerëzore, e shfrytëzonin atë mirë.

Një herë, me rastin e ditës së dhjetë të muajit Muharrem të kalendarit islam, një rrëfenjtar i kushtoi të gjithë performancën e tij rëndësisë së asaj dite të veçantë, ai e bëri këtë në emër të Pejgamberit a.s. duke rrëfyer një mori traditash. Kur e pyetën për burimin e këtyre traditave, ai pa pikën e turpit tregoi se nuk i kishte mësuar ato nga asnjë burim, por se i kishte trilluar ato aty për aty.⁵⁹

Një ditë Ahmed ibn Hanbeli dhe Jahja ibn Ma'ini po falnin namazin në një xhami kur ata panë një rrëfenjtar që po thoshte një traditë në emër të Pejgamberit a.s. nëpërmjet një zinxhiri transmetimi në të cilin burimet e tij të drejtpërdrejta, siç pretendonte, ishin pikërisht ata, Ibn Hanbeli dhe Ibn Ma'ini. Hadithi, i cili ishte kaq i gjatë sa që mund të zinte edhe njëzet faqe libri, kishte të bënte me deklaratën "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut", dhe më tutje tha se Allahu krijoi nga çdo fjalë e shqiptuar një shpend që ka një


⁵⁹ Ibid., vol.1, fq.20.



MENDIMI ISLAM



LOGOS·A



Në botën e sotme komplekse dhe të paqëndrueshme pasojat e të mbështeturit mbi hadithe të shpikura dhe mashtruese për të legjitimuar sjelljen ekstremiste, për të nxjerrë fetva të dhunshme, dhe për të justifikuar abuzimin e hapur, sidomos të grave, nuk janë vetëm tejet të thjeshta, por ç'është e vërteta edhe të rrezikshme. Ky studim gjurmon me hollësi të kujdesshme zhvillimin historik të traditave gojore dhe të shkruara, si edhe përpjekjet e shumta që kanë ndodhur për trillimin e disa haditheve, duke kritikuar kësodore në hollësi metodike hadithe të caktuara që përgjithësisht janë pranuar si “autentikë”.

Përmbledhjet e shquara të Hadithit që ne kemi sot në dispozicion, janë bërë të mundura nga zhvillimi i shkencës së kritikizmit të Hadithit, dhe dijetarët muslimanë meritojnë vlerësimin më të thellë për punën e tyre skrupuloze, si edhe për kontributin e tyre të paçmuar në lidhje me ruajtjen e literaturës së Hadithit, duke bërë më të mirën sipas aftësive të tyre. Megjithatë, këmbëngul autori, procesi është i vazhdueshëm, dhe politika e dyerve të mbyllura që rrethon aktualisht autentifikimin e hadithit ka nevojë që të shqyrtohet me kujdes.

Dr. Israr Khan ka një titull doktorature (PhD) nga Universiteti Musliman Aligarh në Indi. Ai aktualisht është Profesor i Asociuar në Departamentin e Studimeve të Kur'anit dhe Sunetit në Universitetin Ndërkombëtar Islam të Malajzisë (IIUM). Fushat e tij kryesore të studimit, mësimdhënies dhe hulumtimit janë Studimet kur'anore dhe Studimet e hadithit. Ai ka përkthyer disa tituj të Studimeve Islame nga gjuha arabe në gjuhën urdu, anglisht dhe gjuhën hindi, dhe ka shkruar disa vepra në anglisht.